

1 E mërkurë, 15 shtator 2021

2 [Deklaratat Hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 09.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur.

8 Përpara se të fillojmë, dua t'u jap mundësi fotografëve  
9 të bëjnë disa foto. Ju lutem, vazhdoni. Faleminderit.

10 Znj. sekretare, të lutem thirr çështjen.

11 ZNJ. SEKRETARE E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të  
12 nderuar. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
13 Specializuar kundër Salih Mustafës.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Përpara sesa t'u kërkoj të pranishmëve të prezantohen, dua t'u  
16 kujtoj të gjithëve disa rregulla të cilat duhen respektuar  
17 gjatë gjithë kohës.

18 Ju lutem, përpara se të flisni sigurohuni që të  
19 aktivizoni, të ndizni mikrofonin dhe kur të mbaroni ta fikni.  
20 Flisni ngadalë dhe qartë, sepse kemi përkthim në shqip dhe nga  
21 shqipja dhe në serbisht dhe në këtë mënyrë përkthyeset mund të  
22 punojnë si duhet. Përpara sesa të ndërhyri, ju lutem, prisni  
23 nja pesë sekonda përpara sesa të filloni të flisni për t'u  
24 lejuar përkthyesve të përfundojnë fjalinë që janë duke  
25 përkthyer.

1 Gjithashtu, dua t'ju kujtoj se kjo seancë mbahet e hapur,  
2 përveçse, kur kërkohet nga palët apo nga Mbrojtësi i Viktimave  
3 apo kur vendoset nga Trupi Gjykses. Gjithashtu, dëshiroj t'u  
4 kujtoj palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave se disa informata në  
5 këtë çështje janë objekt i masave mbrojtëse dhe urdhrave të  
6 konfidencialitetit. Informacioni konfidencial nuk nxirret në  
7 seancë të hapur.

8 Dhe, ju kujtoj që të më njoftoni paraprakisht nëse ndonjë  
9 parashtrim kërkon nxjerrje informacioni konfidencial me qëllim  
10 që atë futemi në seancë private apo të mbyllur.

11 Gjithashtu, u kujtoj palëve që t'u përmbahen procedurave  
12 sikurse parashikohen në paragrafët 43 deri në 44 të vendimit  
13 të Trupit Gjykses për zhvillimin e procedurave në lidhje me  
14 redaktimet në Gjykatë.

15 Tani, ju lutem, palëve të prezantohen Mbrojtësi i  
16 Viktimave dhe Zyra Administrative. Fillojmë me Prokurorinë.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar.  
18 Mirëmëngjesi të gjithëve. Sot prokuroria prezantohet nga z.  
19 Jack Smith, prokuror i specializuar; Filippo De Menicis,  
20 bashkëshoqërues; Silvia D'Ascoli, një tjetër bashkëprokurore;  
21 unë vetë dhe bashkë me ne kemi Julie Mann që është  
22 përgjegjësja, menaxherja e çështjes.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Faleminderit z. prokuror.

25 Tani i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave, keni fjalën.

1 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,  
2 dhe mirëmëngjes të gjithëve. Ekipi i Mbrojtjes së Viktimave  
3 sot përfaqësohet nga bashkëmbrojtësja Liesbeth Zegveld, nga  
4 Marie-Pier Barbou që është ndihmëse juridike kryesore, dhe  
5 Njomza Haxhibeqiri, ndihmëse juridike e dytë, si dhe nga unë  
6 vetë - Anni Pues, mbrojtëse e viktimave.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit Mbrojtësve.

9 Tani e ka fjalën Mbrojtja.

10 Z. VAN BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, anëtarë të  
11 nderuar të Gjykatës, sot Mbrojtja prezantohet nga Betim Shalaj  
12 që do të jetë me ne nga larg; Fatmir Pelaj që është hetuesi,  
13 gjithashtu do të jetë i pranishëm nga larg dhe sot është i  
14 pranishëm z. Mustafa dhe unë vetë që jam mbrojtësi, Julius Von  
15 Bone. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
17 Zyra Administrative, ju lutem.

18 ZYRA ADMINISTRATIVE: [Përkthim] Mirëmëngjes të nderuar.  
19 Të pranishëm këtu ja unë, administratorja, Fidelma Donlon dhe  
20 zëvendësi im z. Stephan Wohlfahrt.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Neve  
22 për procesverbal jemi ne, unë kryesuesja, Veldt-Foglia dhe  
23 kolegët e mi, Roland Dekkers dhe Gilbert Bitti.

24 Seanca e sotme i kushtohet procedurave, siç parashikohen  
25 në rregullore dhe deklaratat hapëse.

1 Deklaratat hapëse do të dëgjohen në tre seanca, duke  
2 filluar sot në mëngjes deri në orën 11.00, pastaj do të  
3 vazhdojmë nga ora 11.00 deri në 13.00 dhe pastaj nga ora 14.30  
4 deri në 16.00 dhe mund të ketë dhe një seancë tjetër në orën  
5 16.30 deri në 17.30.

6 Do të përpiqemi që sot ta përfundojmë seancën dëgjimore  
7 në fund të seancës së fundit në 17.30 që të mos i ngarkojmë më  
8 shumë përkthyesit me punë të tepërt.

9 Gjithashtu, kemi parashikuar dhe një seancë për nesër,  
10 sigurisht, në datën 16 që është ditë rezervë për ne, nëse nuk  
11 mbarojmë sot, pra, për të vazhduar nesër.

12 Mbrojtja ka vënë në dukje se ka ndërmend të bëjë një  
13 deklaratë hapëse pas përfundimit të paraqitjes së provave nga  
14 Prokurori i Specializuar dhe përpara paraqitjes së provave nga  
15 Mbrojtja.

16 Përpara sesa të fillojmë me procedurën e parashikuar në  
17 rregullin 124 dhe rregullin 125 duam të japim një histori  
18 procedurale të shkurtër të çështjes.

19 Në 13 shkurt 2020, ZPS-ja paraqiti përpara Gjykatësit të  
20 Procedurës Paraprake për konfirmim një Aktakuzë kundër z.  
21 Mustafa bashkë me material provues në mbështetje të akuzave  
22 faktike bashkë me një kërkesë për ta arrestuar dhe transferuar  
23 këtu z. Mustafa.

24 Në 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
25 nxori një vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër z. Mustafa

1 dhe po atë ditë Gjykatësi miratoi kërkesat për fletë-arrestin  
2 dhe transferimin e z. Mustafa këtu.

3 Në 24 pastaj z. Mustafa u arrestua dhe u transferua në  
4 objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.

5 Dhe në 7 maj të këtij viti, kjo çështje u kalua në Trupin  
6 Gjykues nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

7 Në 18 qershor si Trup Gjykues morëm vendim për të  
8 përcaktuar datën e fillimit të gjyqit sot, 15 shtator.

9 Pastaj, si Gjykatësi i Procedurës Paraprake edhe Trupi  
10 Gjykues kanë lëshuar vendime për pjesëmarrjen e viktimave  
11 gjatë procedurave dhe deri tani kemi pranuar nëntë viktima për  
12 të marrë pjesë në këtë çështje.

13 Në përputhje me rregullin 124(2), të paragrafit 2, pra, i  
14 rregullores, gjyqi do të vazhdojë tani me leximin e Aktakuzës  
15 ashtu siç është konfirmuar që do ta bëjë Zyra e Prokurorisë.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Si mbas udhëzimeve tuaja, e  
17 nderuar Gjykatëse dhe meqenëse nuk kishte kundërshtim nga  
18 Mbrojtja do të lexojmë akuzat e ngritura kundër z. Mustafa dhe  
19 jo të gjithë Aktakuzën në tërësinë e vet.

20 Në Aktakuzën e konfirmuar Prokurori i Specializuar akuzon  
21 z. Salih Mustafa me:

22 Pika 1: Krimin e luftës të ndalimit arbitrar si mbas  
23 nenit 14(1)(c) të ligjit të kryer në një kompleks ndalimi në  
24 Zllash në Kosovë kundër të paktën gjashtë personave nga  
25 afërsisht 1 prilli 1999 deri 19 prill 1999.

1 Pika 2: Krimin e luftës së trajtimit mizor sipas nenit 14  
2 paragrafi 1(c)(i), e ligjit, kryer në një kompleks ndalimi në  
3 Zllash, në Kosovë, kundër të paktën gjashtë personave nga,  
4 afërsisht, 1 prill 1999 dhe 19 prilli 1999.

5 Pika 3: Krimi i luftës për torturë, sipas nenit  
6 14(1)(c)(i), kryer në kompleksin e ndalimit që ndodhet në  
7 Zllash, në Kosovë, kundër të paktën gjashtë personave,  
8 afërsisht, nga 1 prill 1999 dhe 19 prill 1999; dhe

9 Pika 4: Krimi i luftës për vrasje të paligjshme sipas  
10 nenit 14(1)(c)(i) të ligjit kryer në kompleksin e ndalimit që  
11 ndodhet në Zllash, në Kosovë kundër një personi, midis  
12 afërsisht, 19 prilli 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999.

13 Në lidhje me këto krime, ka një dyshim të mirëbazuar se  
14 z. Mustafa është përgjegjës penalisht sipas nenit 16(1)(e)(a)  
15 të ligjit, për :

16 - Kryerjen fizikisht të krimeve sipas pikave 1 deri në  
17 pikën 3;

18 - Për kryerjen si anëtar i një ndërmarrje kriminale të  
19 përbashkët të krimeve sipas pikave 1 deri në 4: dhe pikën 4  
20 duke e kryer si një anëtar i ndërmarrjes kriminale të  
21 sipërpërmendur krimin e vrasjes së qëllimshme duke qenë i  
22 vetëdijsëm se një krim i tillë mund të kryhet duke kryer  
23 qëllimin e përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët  
24 dhe duke e marrë këtë rrezik me vullnetin e tij të lirë;

25 - Duke urdhëruar krimet sipas pikave 1 deri në 3;

1 - Duke nxitur krimet sipas pikave 1 deri në 3; dhe

2 - Më tej dhe nga ana tjetër duke e ndihmuar dhe

3 inkurajuar krimet sipas pikave 1 deri në pikën 4;

4 - Gjithashtu dhe nga ana tjetër për përgjegjësinë e

5 pretenduar sipas nenit 16(1) (a) të ligjit ka një dyshim të

6 mirëbazuar se z. Mustafa është përgjegjës penalisht për krime

7 sipas pikave 1 deri në 4 si epror në bazë të nenit 16(1) (c) e

8 ligjit.

9 Faleminderit shumë, të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Z. Mustafa, të lutem ngrihu në këmbë.

13 Z. Mustafa, besoj që ti e kupton natyrën e akuzave që

14 janë ngritur kundër teje. Kështu është?

15 I AKUZUARI: Po, e kuptoj po s'ka asgjë me të vërtetën.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Mustafa gjatë paraqitjes suaj në datën 28 tetor të vitit që

18 shkoi t'i nuk u deklarove fajtor për asnjë nga akuzat e

19 Aktakuzës së konfirmuar.

20 Prit, do ta bëj unë pyetjen.

21 Tani ke mundësinë dhe rastin të konfirmosh deklaratën

22 tënde.

23 E konfirmon deklaratën tënde të parë se nuk je fajtor

24 për asnjë akuzë?

25 I AKUZUARI: Saktë. Nuk jam fajtor për asnjë nga pikat që

1 m'i ngarkon kjo zyrë e Gestapos.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit z. Mustafa, mund të uleni.

4 Z. Mustafa, më lejoni t'ju informoj për disa të drejta të  
5 rëndësishme që i ke në kuadrin ligjor të kësaj Gjykate.

6 Ke të drejtën të mos flasësh, por një heshtje e tillë nuk  
7 do të jetë një faktor për vendimin e pafajësisë apo fajësisë  
8 tënde.

9 Ti ke të drejtën të mos detyrohesh të pranosh fajin apo  
10 të dëshmosh.

11 Ti ke të drejtën të mos inkriminosh veten apo anëtarët e  
12 tu të afërme të familjes.

13 Ke të drejtën të përfaqësohesh nga një Mbrojtës dhe  
14 konstatoj se z. Von Bone, Mbrojtësit e Specializuar të  
15 përfaqësojnë ty.

16 Ke të drejtën të kesh kohë dhe mjete të mjaftueshme për  
17 përgatitjen e mbrojtjes tënde dhe të drejtën për të komunikuar  
18 me Mbrojtësin tënd.

19 Ke të drejtën të gjykohesh brenda një kohe të arsyeshme.

20 Ke të drejtën të pyesësh apo të kërkosh të tjerët të  
21 pyesin dëshmitarët që janë këtu kundër teje dhe të marrësh, të  
22 sigurosh praninë e dëshmitarëve në emër tënd.

23 Ke të drejtë të bësh një deklaratë të pabetuar dhe të  
24 paraqitesh si dëshmitar nën betim.

25 Gjithashtu duhet të të informoj se mund të urdhëroj



1 heqjen tënde të përkohshme, largimin tënd të përkohshëm nga  
2 kjo dhomë, nga kjo sallë gjyqi nëse ti prish rendin këtu në  
3 këtë sallë gjyqi.

4 Tani, Trupi Gjykues do të vazhdojë me dëgjimin e  
5 deklaratave hapëse. Së pari do të dëgjojmë nga Zyra e  
6 Prokurorisë pjesën e parë do ta paraqesë z. Jack Smith,  
7 prokurori i specializuar dhe më informojnë që pjesën e dytë do  
8 ta mbajë prokurori tjetër Michalczuk.

9 Dhe pastaj do të dëgjojmë Mbrojtësin e Viktimave. Sipas  
10 vendimit për Zhvillimin e Procedurave kemi tre orë për  
11 paraqitjen e deklaratave hapëse dhe një orë e gjysëm për  
12 Prokurorinë dhe një orë e gjysëm për Mbrojtësin e Viktimave.

13 Përpara se t'ju jap fjalën, a mund të më thoni, nëse ju  
14 dhe kolegu, do ta përdorni të gjithë kohën, pra, tre orë që  
15 keni, që ju kemi caktuar apo do të përdorni më pak kohë. Sa  
16 për të planifikuar kohën.

17 Z. SMITH: [Përkthim] Po, e nderuar, do të përdorim besoj  
18 një orë jo më shumë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit për këtë informacion.

21 Z. Smith keni fjalën.

22 Z. SMITH: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, zonja  
23 Administratore, të nderuar avokatë, mirëdita.

24 Si Prokuror i Specializuar kam kënaqësinë dhe privilegjin  
25 t'ju drejtohem sot që fillojmë gjykimin e parë në këtë

1 Gjykatë.

2 Dita e sotme është një datë e rëndësishme në jetën e  
3 këtij institucioni të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe  
4 të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të cilin unë e  
5 drejtoj. Dëshiroj të falënderoj secilin prej vendeve të  
6 Bashkimit Evropian dhe shtetet kontribuuese Norvegjinë,  
7 Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuar të Amerikës. Bujaria dhe  
8 përkushtimi i të cilave kundrejt shtetit ligjor ka mundësuar  
9 të gjithë këtë proces dëshiroj të falënderoj edhe të gjithë  
10 punonjësit tanë, si të tanishëm edhe të mëparshëm si dhe  
11 organet e tjera të kësaj Gjykate për përkushtimin e palëkundur  
12 për të na sjellë në këtë ditë.

13 Së fundi, u jam shumë mirënjohës për mbështetjen  
14 thelbësore shumë njerëzve që kanë bashkëpunuar me Gjykatën  
15 tonë në Kosovë dhe gjetkë, duke na dhënë prova, duke na  
16 treguar historitë e tyre dhe të njerëzve të tyre të dashur dhe  
17 mbi të gjitha për besimin që kanë treguar se ky institucion do  
18 të vendosë në vend drejtësinë. Pa ata, zyra që unë drejtoj nuk  
19 do të kishte mundur ta kryente deri tani detyrën e ngarkuar.  
20 Është bashkimi i të gjitha këtyre përpjekjeve ai që e ka bërë  
21 të mundur të jemi këtu sot për të shënuar fillimin e gjykimit  
22 të parë të këtij institucioni.

23 Gjykata jonë dhe këto procese gjyqësore shihen ndryshe  
24 nga njerëz të ndryshëm. Pikë së pari, kjo Gjykatë është një  
25 Gjykatë e frymëzuar nga zëra kosovarë dhe e krijuar me akte të

1 popullit kosovar. Më 3 gusht të vitit 2015 Kuvendi i Kosovës e  
2 krijoi këtë gjykatë me anë të miratimit të ligjit për Dhomat e  
3 Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Po atë  
4 ditë, Kuvendi i Kosovës votoi edhe ndryshimin e Kushtetutës së  
5 Kosovës, gjegjësisht për të ratifikuar ekzistencën e Dhomave  
6 të Specializuara të Kosovës dhe të Zyrës së Prokurorit të  
7 Specializuar brenda kornizës së Kosovës.

8 Përmes këtyre veprimeve dhe duke folur në emër të  
9 popullit të Kosovës, Kuvendi u ngarkoi këtyre institucioneve  
10 detyrën për t'u mbështetur në punën e Task Forcës Hetimore  
11 Speciale dhe për të gjykuar personat përgjegjës për krimet e  
12 rënda ndërkombëtare dhe ndërkufitare të kryera në territorin e  
13 Kosovës dhe në pjesë të Shqipërisë gjatë periudhës 1 janar  
14 1998 deri në 31 dhjetor 2000. Gjashtë vjet më pas tek po  
15 fillojmë gjykimin e parë, kjo Gjykatë është krenare që  
16 sinjalizon angazhimin e popullit të Kosovës për një shtet  
17 ligjor dhe për një drejtësi transparente.

18 Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit  
19 të Specializuar janë institucione të Republikës së Kosovës.  
20 Ato zbatojnë të drejtën ndërkombëtare, të drejtën e zbatueshme  
21 për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, si pjesë e  
22 sistemit juridik të Kosovës dhe rregullohen nga Kushtetuta e  
23 Kosovës. Megjithëse Gjykata jonë është e pajisur me gjykatës  
24 dhe juristë nga vende të tjera jashtë Kosovës nuk duhet  
25 harruar se forca e vërtetë shtytëse e punës së zyrës që unë

1 drejtoj dhe ekzistencës së këtij institucioni ka qenë populli  
2 i Kosovës.

3 Pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e shumë e shumë  
4 kosovareve dhe kosovarëve, sot nuk kishim për të qenë këtu.

5 Kjo është një gjykatë kosovare por është edhe një gjykatë  
6 për viktimat dhe me viktimat. Për shumë prej nesh, janë  
7 viktimat me historinë e tyre që e çojnë përpara këtë proces  
8 dhe na shtyjnë përpara në punën tonë. Gjatë gjykimit të kësaj  
9 çështje gjyqësore, do të dëgjoni prej viktimave të cilat kanë  
10 dy dekada, dy dekada që presin t'u dëgjohet zëri, dy dekada  
11 për të kërkuar drejtësi për krimet e kryera kundër tyre dhe  
12 kundër anëtarëve të familjes së tyre që nuk ndodhen më mes  
13 nesh.

14 Nëse do të donim t'u shërbenim siç duhet këtyre  
15 viktimave, nuk do të mund të ketë më kurrë një datë skadimi  
16 për dhënien llogari. Siç e dimë nga konflikte në mbarë botën,  
17 nuk është gjithmonë e mundshme të vihet drejtësia në vend për  
18 viktimat menjëherë pas një konflikti. Në kushte të tilla, siç  
19 është lufta në Kosovë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që  
20 viktimat ta dinë se ka njerëz të cilët duan t'ia dinë dhe se  
21 do të vijë një ditë që në farë mënyre, krimet e kryera kundër  
22 tyre do të dalin tërësisht në dritë dhe se personat që mbajnë  
23 më së shumti përgjegjësi për këto krime do të dalin para  
24 drejtësisë.

25 Dhënia e dëshmisë në lidhje me aktet brutale të kryera

1 kundër tyre në vetvete mund të jetë tronditëse për viktimat  
2 por, nëse bëhet me mbështetjen e duhur, dëshmia e tyre mund të  
3 ketë një vlerë pozitive madje mund të shërbej si katarsis për  
4 to. E di se Administratorja dhe personeli që ajo drejton do të  
5 bëjnë gjithçka që munden për tu dhënë mbështetjen e duhur  
6 këtyre njerëzve të guximshëm që tua tregojnë historitë e tyre  
7 juve. Unë vetë dhe punonjësit që unë drejtoj e kemi për nder  
8 të luajmë rolin tonë për t'ua dhënë këto mundësi të dëgjohen.

9 Do të thërriten këtu disa viktima të të akuzuarit në këtë  
10 çështje gjyqësore. Ndërsa në çështjet e tjera gjyqësore  
11 përpara Gjykatës do të thërrasim viktima të kombësive të  
12 ndryshme si shqiptare, serbe, rome dhe të kombësive të tjera.  
13 Në këtë çështje, në veçanti, do të shihni se viktimat e të  
14 akuzuarit, z. Mustafa, ishin të gjithë shqiptarë të Kosovës si  
15 edhe ai vetë. Pra viktimat e z. Mustafa ishin të gjithë  
16 bashkëshqiptarë të Kosovës.

17 Këta njerëz nuk ishin armiq të shtetit të Kosovës. Nuk  
18 ishin spiunë. Ata ishin të së njëjtës bashkësi, shqiptarë të  
19 pafajshëm të Kosovës, krimi i vetëm i të cilëve ishte se  
20 konsideroheshin, për një arsye a një tjetër, si pengesë ndaj  
21 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe disa prej udhëheqësve të  
22 saj. E për këtë arsye etiketoheshin si kolaboracionistë.

23 Për ata që kanë qenë kundërshtarë të këtij institucioni  
24 dhe ata që kanë kërkuar t'ia pengojnë punën kësaj Gjykate dhe  
25 Zyrës që unë drejtoj sa herë ju është dhënë mundësia, ky është

1 një fakt që nuk u vjen për mbarë, por gjithsesi mbetet fakt  
2 dhe një fakt i pamohueshëm. E vërteta, siç do të dalë përpara  
3 kësaj Gjykate në javët në vijim, është se disa udhëheqës të  
4 caktuar të UÇK-së, përfshirë këtu dhe z. Mustafa, e përdorën  
5 pushtetin e tyre për t'i viktimizuar dhe brutalizuar  
6 bashkëkosovarët shqiptarë, ndër të tjera dhe individë, krimi i  
7 vetëm i të cilëve ishte se kishin pikëpamje politike që nuk  
8 përputheshin me pikëpamjet politike të UÇK-së dhe udhëheqësve  
9 të saj. Siç do ta shihni në provat që do të paraqiten nuk ka  
10 pasur asnjë objektiv ushtarak legjitim për ndalimin e tyre dhe  
11 asnjë justifikim të mundshëm për kushtet çnjerëzore në të  
12 cilat janë mbajtur, apo për mënyrën me të cilën janë  
13 brutalizuar dhe torturuar gjatë ndalimit.

14 Kam ardhur kështu tek çështja e përgjegjësisë penale  
15 individuale. Puna e një prokurori është llogaridhënia,  
16 llogaridhënia individuale për krimet që mund të vërtetohen  
17 përtej një dyshimi të arsyeshëm. Përgjegjësia penale për  
18 krimet e gjykuara nga kjo Gjykatë është vetjake. Neni 9 i  
19 ligjit e mishëron këtë parim duke ju dhënë Dhomave të  
20 Specializuara të Kosovës kompetencë mbi personat fizikë.  
21 Dëshiroj ta theksoj sepse ka rëndësi themelore për të kuptuar  
22 çështjen që do të filloni të gjykoni sot.

23 Hetimet e ZPS-së janë përqendruar vetëm tek individët të  
24 cilët, siç do ta dëshmojnë provat në këtë gjykim, u kanë  
25 shkaktuar vuajtje të pallogaritshme shpesh mu atyre njerëzve

1 për të cilët do të duhej të kishim luftuar dhe cilët duhet të  
2 mbronin. Z. Mustafa ka shkelur ligjet e luftës dhe ligje të  
3 tjera ndërkombëtare që ekzistojnë për mbrojtjen e njerëzimit  
4 nga abuzimet e të pushtetshmeve.

5 ZPS-ja nuk ngre akuza kundër UÇK-së apo kundër luftës së  
6 bërë për pavarësinë. Nuk është as dëshira, as detyra e ZPS-së  
7 apo e imja për të bërë një gjë të tillë. Disa njerëz shpesh,  
8 po ata që janë përpjekur t'i frikësojnë viktimat e  
9 dëshmitarët, janë përpjekur të krijojnë pështjellim në këtë  
10 aspekt për ta zbehur këtë dallim të rëndësishëm. Ata kanë  
11 pretenduar se këto gjyqe bëhen kundër Kosovës dhe popullit  
12 kosovar. Kjo nuk është aspak, aspak e vërtetë. Përkundrazi,  
13 fakti që populli i Kosovës vendosi ta krijojë këtë institucion  
14 për të bërë punën që po bën, përbën dëshmi të angazhimit të  
15 tij për shtetin ligjor.

16 Siç do ta tregojë ky gjyq dhe, gjyqet që do të pasojnë,  
17 akuzat kanë të bëjnë me individë të përmendur me emra të cilët  
18 kanë vepruar pa treguar asnjë fije konsiderate për jetën,  
19 lirinë dhe dinjitetin e njeriut. Akuzat e ngritura në këtë  
20 gjyq kanë të bëjnë me përfshirjen e të akuzuarit si individ në  
21 ndalimin, keqtrajtimin dhe torturimin e kosovarëve. Ky gjyq ka  
22 të bëjë me përgjegjësinë vetjake të të akuzuarit, z. Mustafa,  
23 veprimet e të cilit kanë shkaktuar vuajtje që kanë lënë plagë  
24 të pashërueshme në trupat dhe mendjet e viktimave që kanë  
25 vuajtur prej këtyre veprimeve.

1 Do të dëgjoni, të nderuar Gjykatës, edhe anëtarët e  
2 familjes së njërit prej viktimave të të akuzuarit që nuk  
3 arriti të shpëtonte gjallë sepse u vra pasi e torturuan  
4 brutalisht në mënyrë të përsëritur. Është përgjegjësia  
5 individuale vetjake e të akuzuarit për atë që iu bë këtij të  
6 riu, si edhe për krimet e tjera për të cilat ngrihen akuzat, e  
7 për këtë ndodhemi këtu sot.

8 Arsyeya pjesërisht përse është krijuar kjo Gjykatë dhe  
9 natyrisht përse është vendosur në Hagë, është atmosfera e  
10 frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në proceset penale  
11 të zhvilluara kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Kjo atmosferë  
12 ekziston edhe sot dhe do të përbëj sfondin shoqëruar të këtij  
13 gjyqi.

14 Ndërkohë që para kësaj Gjykate do të dalin të dëshmojnë  
15 dhe të tregojnë historinë e tyre dëshmitarë që jetojnë përditë  
16 në këtë atmosferë, të nderuarve Gjykatës do t'ju kërkoja të  
17 shikojnë sesi dhe kur dëshmia e tyre cenohet nga trysnia që  
18 shumë dëshmitarë kanë ndjerë për të mos u ndierë, për të mos e  
19 ngritur zërin në lidhje me të vërtetën që kam parë me sy apo  
20 që kanë pësuar vetë.

21 Edhe sot e kësaj dite, kjo atmosferë frikësimi, lufta  
22 ndaj së cilës ka qenë dhe është një prej përparësive më me  
23 rëndësi të zyrës që drejtoj nuk ja ka dalë mbanë të arrijë  
24 objektivin. Ndodhemi këtu sot ngaqë nuk ja ka arritur t'i  
25 ndalojë njerëzit që t'i tregojnë historitë e tyre përpara



1 jush. Dëshira e tyre për drejtësi dhe pajtim ka dalë më e  
2 fortë se ajo e një grushti individësh të cilët për interesa  
3 personale dhe për arsye të tjera të liga janë përpjekur ta  
4 pengojnë rrugën drejtë llogaridhënies dhe tua heqin viktimave  
5 të drejtën për drejtësi. Duhet të qëndrojmë syçelët për të  
6 mbështetur siç duhet këta dëshmitarë, duke pasur parasysh atë  
7 që dimë që u është dashur të përballojmë për të dalë në bankën  
8 e dëshmitarit përpara kësaj Gjykate.

9 Ky institucion, Dhomat e Specializuara të Kosovës,  
10 përfaqëson shumë gjëra për shumë njerëz. Për shumë vetë në  
11 Kosovë, kjo Gjykatë përbën mundësinë e fundit për drejtësi për  
12 një numër të madh viktimash.

13 Për fat të keq, ka të tjerë që e shohin këtë Gjykatë si  
14 diçka të cilat nuk duhet pasur besim dhe e cila duhet  
15 sulmuar.

16 Kundërshtarët e këtij institucioni shpesh e kanë  
17 përshkruar konfliktin në të cilin është kyçur UÇK-ja si një  
18 luftë të pastër bazuar në premisën se, meqenëse kauza ishte e  
19 drejtë, atëherë asnjë anëtar i UÇK-së nuk ka mundësi të ketë  
20 vepruar në mënyrë të paligjshme ndërkohë që i shërbente kësaj  
21 kauze. Janë po këta kundërshtarë të cilët shpesh përmendin  
22 krimet e kryera nga kundërshtarët e tyre si një justifikim të  
23 plotë për krimet e kryera nga ta që mbanin anën e tyre në këtë  
24 konflikt. Këta kundërshtarë të kësaj Gjykate përdorin fraza të  
25 tilla si "lufta e pastër" si një orvatje cinike për ta

1 manipuluar krenarinë e justifikueshme kombëtare të kosovarëve  
2 kundër një institucioni që është dëshmia e angazhimit të këtij  
3 vendi për shtetin ligjor dhe që do të vendosë në vend  
4 drejtësinë për shumë vetë edhe për një numër të madh  
5 shtetasish të Kosovës, që kanë vuajtur nga krimet e pretenduar  
6 në Aktakuzat e ZPS-së.

7 Si Prokuror, nuk bën pjesë në tagrin tim t'ju argumentoj  
8 apo të vendos se çfarë lufte është e drejtë e çfarë lufte nuk  
9 është e drejtë, por mund të them me bindje se krimet e luftës  
10 të njërës anë nuk justifikojnë krimet e luftës të anës tjetër.  
11 Mbase më me rëndësi, mund të them se e di se e vërteta nuk e  
12 dëmton kurrë kauzën e drejtë. Atyre që nuk kanë besim te  
13 drejtësia dhe transparenca e kësaj Gjykate, u them ta ndjekin  
14 këtë gjyq dhe gjyqet që do të vijnë pas tij, ta shohin sesi  
15 funksionon kjo Gjykatë e pastaj ta gjykojnë. Standardet e  
16 procesit të rregullt janë ndjekur, ndiqen dhe pa dyshim do të  
17 ndiqen në maksimum nga ky institucion. Që ky institucion ta  
18 përmbushë detyrën e ngarkuar se cili prej të akuzuarve të  
19 gjykuar nga kjo Gjykatë, duke filluar me z. Mustafa, duhej të  
20 gjykohen në mënyrë të drejtë në përputhje me standardet më të  
21 larta ndërkombëtare. Nuk kam dyshim që kjo do të ndodhë në  
22 rastin e z. Mustafa dhe të çdo të akuzuari në gjyqet e tjera  
23 në vijim.

24 Të nderuar Gjykatës, në përfundim dua të them se puna e  
25 kësaj Gjykate përbën një mundësi, një mundësi që Kosova t'i

1 lërë pas njëherë e përgjithmonë problemet e kësaj lufte. Një  
2 mundësi që viktimave t'u dëgjohe zëri në kushtet ku mund ta  
3 thonë të vërtetën pa pasur frikë nga hakmarrja apo frikësimi.  
4 Është gjithashtu që të akuzuarit -- për të akuzuarin - më  
5 falni - që akuzat kundër tij të dëgjohe publikisht dhe të  
6 kundërshtohen nga avokatë të aftë si z. Von Bone. Nëse ne, si  
7 Prokurori, nuk do të jemi në gjendje ta mbajmë barrën e provës  
8 për akuzat e ngritura atëherë kjo do të ishte një mundësi që  
9 të akuzuarit ta ç'njollosin njëherë e përgjithmonë emrin e  
10 tyre.

11 Unë besoj thellësisht dhe vendosmërisht se kjo Gjykatë  
12 është një mundësi për të treguar se drejtësia penale  
13 ndërkombëtare mund të funksionojë se nuk është nevoja që  
14 gjyqet të zgjasin me vite, se drejtësia mund të jetë e plotë e  
15 arsyetuar, transparente, efikase dhe e drejtë, se mund të  
16 mbështetemi te më e mira e tribunaleve të mëparshme, se mund  
17 të zbatojmë standarde rigoroze për mësimet e nxjerra në çdo  
18 aspekt të institucionit tonë për të arritur një funksionalitet  
19 dhe praktikalitet që, sinqerisht, ka qenë shpesh i pakapshëm  
20 prej institucionet e drejtësisë penale ndërkombëtare në të  
21 shkuarën.

22 Është një mundësi për të dëshmuar se krijimi dhe  
23 mbështetja e Gjykatave të kësaj natyre ka kuptim sepse ato  
24 mund të funksionojnë në mënyrë efektive dhe të kontribuojnë në  
25 drejtësi në publikimin dhe njohjen e fakteve dhe në fund, me

1 shpresë edhe në shërimin e plagëve.

2 Kjo Gjykatë është një kontribut për projektin madhor të  
3 drejtësisë penale ndërkombëtare dhe çdo çështje gjyqësore që  
4 zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe të drejtë para saj e  
5 shton edhe më shumë këtë kontribut.

6 Edhe pse kjo Gjykatë shihet ndryshe nga persona të  
7 ndryshëm është mirë, madje duhet, që nga të gjithë të shihet  
8 si një mundësi për të kërkuar drejtësi.

9 Ju falënderoj për mundësinë që t'ju drejtohem sot. Do  
10 t'ia jap tani fjalën prokurorit Michalczuk, i cili do t'ua  
11 ilustrojë të nderuarve Gjykatës dhe publikut me më shumë  
12 hollësi çështjen gjyqësore për të cilën jemi këtu sot dhe sesi  
13 ZPS-ja do të vërtetojë se i akuzuari është personalisht  
14 përgjegjës për krimet për të cilat akuzohet.

15 Faleminderit shumë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Michalczuk, ju e keni fjalën.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, çështja që  
19 do të paraqesë Prokuroria është e thjeshtë dhe e  
20 drejtpërdrejtë.

21 Në prill të vitit 1999, gjatë luftës në Kosovë, i  
22 akuzuari, z. Salih Mustafa, së bashku me ndihmësit dhe  
23 vartësit e tij ndaluan në mënyrë të paligjshme dhe keqtrajtuan  
24 rëndë një numër civilësh shqiptarë kosovarë të vendit dhe  
25 vranë një civil. Të gjitha viktimat në këtë çështje dhe këtë

1 dua ta theksoj si fakt, janë shqiptarë kosovarë.

2 Sikurse do ta përshkruaj më me hollësi në vijim të kësaj  
3 deklaratë hyrëse, këto viktima që u ndaluan në mënyrë të  
4 paligjshme u mbajtën në kushte të mjerueshme, të  
5 papërshtatshme për njerëz dhe në mënyrë të përsëritur u  
6 keqtrajtuan, maltratuan, kërcënuan dhe [u] rrahën rëndë nga  
7 personat që i mbanin të ndaluar ndër të cilët dhe i akuzuari.  
8 Provat do të tregojnë se të gjitha këto krime ndodhen në një  
9 fshat të vogël dhe izoluar me emrin Zllash, në zonën malore të  
10 Gollakut. Fshati ndodhet jo larg Prishtinës dhe krimet u kryen  
11 përgjatë një periudhe prej rreth tri javësh midis afërsisht 1  
12 dhe 19 prillit 1999.

13 Në fshatin Zllash kishte një qendër të improvizuar  
14 ndalimi ku mbaheshin të burgosurit. Do t'i referohemi këtij  
15 vendi me "kompleksi i ndalimit në Zllash". Ai drejtohej nga  
16 anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konkretisht, nga  
17 një grup i quajtur BIA, -B-I-A- që komandohej nga i akuzuari.  
18 Do t'ju flas për njësitin BIA dhe qëllimin e këtij njësi me  
19 vonë në kuadër të kësaj deklaratë hyrëse.

20 Pse një njësi e UÇK-së po i arrestonte, mbante të ndaluar  
21 dhe keqtrajtonte në mënyrë të paligjshme shqiptarët e Kosovës  
22 gjatë luftës? Provat do të tregojnë se personat që u sollën  
23 dhe u mbajtën në mënyrë të paligjshme në kompleksin e ndalimit  
24 në Zllash akuzoheshin ndër të tjera se ishin të ashtuquajtur  
25 bashkëpunëtorë ose kolaboracionistë në luftë. Të akuzohesh se

1 je i ashtuquajtur bashkëpunëtor gjatë luftës ishte një e rëndë  
2 dhe shpesh vdekjeprurëse. Por le të jemi shumë të qartë. Këta  
3 persona këta të burgosur nuk ishin bashkëpunëtorë në kuptimin  
4 që e ndihmonin armikun në veprimet e tyre ushtarake apo  
5 luftarake. Jo. Në asnjë mënyrë. Asnjëri nga personat që u  
6 mbajtën në Zllash nuk kishte bërë diçka të tillë dhe askush në  
7 këtë gjykim nuk do të pretendojë se ata kanë bërë një gjë të  
8 tillë.

9 Jo. Përkundrazi, etiketa "bashkëpunëtor" përdorej  
10 gjerësisht dhe në të vërtetë keqpërdorej për persona që kishin  
11 shoqëri me serbët, kishin marrëdhënie biznesi me ta, kishin  
12 lidhje me ta ose thjesht konsideroheshin se nuk e përkrahnin  
13 sa duhet UÇK-në apo se shfaqnin përkatësi të gabuar, të  
14 thuash, politike. Mund të përfundonit në Zllash thjesht në  
15 bazë të dyshimit për veprimtari ose qëndrime të këtij lloji.  
16 Dhe kur të përfundonit aty, të nderuar Gjykatës, do të dëgjoni  
17 dëshmitë e vetë atyre që u rrëmbyen, arrestuan dhe çuan në  
18 Zllash kur u burgosën nga anëtarë të UÇK-së. Ata do të ulen në  
19 karrigen e dëshmitarit dhe do t'ju rrëfejnë për kushtet e  
20 ndalimit, për keqtrajtimet, rrahjet dhe marrjet në pyetje të  
21 përditshme. Do të dëgjoni për lëndimet që pësuan, për mënyrën  
22 sesi u thyen fizikisht dhe traumatizuan psikikisht. Do të  
23 dëgjoni, gjithashtu, edhe dëshmi për një viktimë që nuk  
24 mbijetoi dhe u vra nga ata që e mbajtën të ndaluar.

25 I akuzuari në këtë çështje, z. Salih Mustafa, ishte

1 përgjegjësi i kompleksit të ndalimit në Zllash dhe vetë mori  
2 pjesë në keqtrajtimet dhe rrahjet.

3 Të nderuar Gjykatës, në këtë fjalë hapëse fillimisht do  
4 t'ju flas pak për të akuzuarin dhe pozitën e tij në Ushtrinë  
5 Çlirimtare të Kosovës, me theks të veçantë njësisë BIA që ai  
6 komandonte gjatë kohës që mbulon Aktakuza.

7 Pastaj do të vazhdoj me përshkrimin e vendit ku ndodhën  
8 krimet e paraqitura në Aktakuzë.

9 Më pas, do të flas shkurtimisht për konfliktin e  
10 armatosur në Kosovë, në kontekstin e të cilit i akuzuari dhe  
11 vartësit e tij kryen krimet e paraqitura në Aktakuzë.

12 Pas pjesës për konfliktin e armatosur, juve Gjykatës të  
13 nderuar dhe publiku që ndjek këtë deklaratë hyrëse, do t'ju  
14 paraqes një përmbledhje të shkurtër të krimeve që ndodhën në  
15 kompleksin e ndalimit në Zllash dhe në veçanti do të theksoj  
16 gjendjen e rëndë të viktimave dhe përgjegjësinë e të akuzuarit  
17 në këtë çështje gjyqësore.

18 Salih Mustafa, shqiptar i Kosovës, i lindur më 1 janar  
19 1972 në Prishtinë, ju bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
20 në fillim të shtatorit 1997. Para kësaj, ai kishte qenë anëtar  
21 i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Nga fillimi e  
22 deri në përfundimin e konfliktit në Kosovë në qershor 1999, ai  
23 ishte udhëheqës dhe komandant i njësitit të UÇK-së për  
24 mbledhjen e të dhënave zbuluese dhe për mbështetje me emrin  
25 BIA.

1 Njësiti BIA ishte i organizuar në nën-njësi dhe rreth  
2 marsit 1999 numëronte rreth 500 deri në 600 anëtarë. I  
3 akuzuari ishte komandanti i përgjithshëm i njësitetit. Njësiti  
4 BIA kryente detyra të tilla si: zbulimi, veprime diversante  
5 kundër objekteve dhe njësive të armikut dhe sigurimin e  
6 furnizimeve mjekësore. Një prej detyrave kryesore të saj, të  
7 BIA-s ishte mbledhja e informatave të zbulimit të cilën e  
8 drejtonte vetë i akuzuari. Provat më tej do të tregojnë që  
9 njësiti BIA ishte përgjegjës për kompleksin e ndalimit në  
10 Zllash. Në mars dhe prill 1999, përgjegjës për atë vend ishte  
11 i akuzuari dhe ai ishte i pranishëm gjatë ndalimeve dhe  
12 rrahjeve dhe pjesëmarrës në to.

13 Njësiti BIA mbulonte zonën urbane të Prishtinës, të  
14 Fushë-Kosovës dhe Obiliqit dhe kishte gjithashtu prani në  
15 fshatrat Butovc, Rimanishtë dhe Zllash në rajonin e Gollakut

16 Znj. sekretare e gjykatës, a mund, ju lutem, që të  
17 vendosni diapozitivin numër 1.

18 Të nderuar Gjykatës, në këtë diapozitiv mund të shihni  
19 zonën e përafërt të veprimit të njësitetit BIA. Është zona e  
20 rrethuar me një rreth të kaltër. Dhe besoj që kjo do t'ju  
21 ndihmojë për të kuptuar kontekstin e përgjithshëm gjeografik  
22 të kësaj çështje.

23 Tani të shikojmë, ju lutem, diapozitivin numër 2, që  
24 është fotografi nga afër e diapozitivit numër 1. Aty shihet  
25 zona e veprimit të BIA-s në më shumë hollësi mund ta shikojmë



1 dhe qytetin e Prishtinës dhe zonën përreth ku ka vepruar BIA  
2 gjatë vitit 1999 brenda kohës që lidhet me Aktakuzën.

3 Simboli i njësimit BIA ishte skifteri. Edhe emri i koduar  
4 i këtij njësiti ishte "Skifteri" që sikurse e shpjegoj i  
5 akuzuari përdorej si emri identifikues i njësisë në  
6 komunikimet me radiolidhje.

7 Tani, të shikojmë diapozitivin numër 3.

8 Anëtarët e njësimit BIA nuk mbanin të gjithë uniformat e  
9 njëjta. Sidoqoftë, disa prej tyre mbanin uniforma të zeza me  
10 një emblemë me skifter dhe fjalën "Skifterat" përreth. Këtë  
11 shenjë, emblemë mund ta shihni në këtë fotografi. Dëshmitari  
12 W01679 do të dëshmojë se ata dhe po citoj "që e arrestuan  
13 kishin një shenjë me skifter dhe fjalën "Skifterat" të shkruar  
14 përreth", përshkrim ky që përputhet me emblemën në këtë  
15 diapozitiv.

16 Në vitin 1999, përfshirë gjatë periudhës së Aktakuzës, i  
17 akuzuari, sikurse e ka pranuar edhe vetë, kryesisht mbante  
18 uniformë ushtarake dhe përdorte beretë të zezë ose të kuqe.  
19 Bereta e kuqe ishte diçka që e mbante vetëm i akuzuari dhe nuk  
20 ishte pjesë e uniformës së njësimit BIA. Të nderuar Gjykatës,  
21 gjatë gjykimit ju do të mësoni se të paktën një dëshmitar që u  
22 mbajt i ndaluar dhe u rrah, u keqtrajtuar në Zllash pa të  
23 akuzuarin me beretë të kuqe.

24 Kur u arrestua i akuzuari në kuletë kishte një fotografi  
25 të vetës me uniformë të UÇK-së dhe me beretë të kuqe në kokë

1 edhe në telefon edhe në pajisjet USB që kishte me vete kishte  
2 fotografi të tij nga koha e luftës përsëri me beretë të kuqe.  
3 Ja disa nga këto fotografi, të shohim diapozitivat me radhë.

4 Diapozitivi 4.

5 Të kalojmë te numri 5.

6 Tani te 6.

7 Diapozitivi numër 7.

8 Numër 8, ju lutem.

9 Numër 9.

10 Të kalojmë te diapozitivi numër 10.

11 Dhe në fund te diapozitivi numër 11.

12 I akuzuari u emërua zyrtarisht komandant i njësimit BIA  
13 në maj të viti 1998 nga z. Rustem Mustafa, komandant i zonës  
14 operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Njësiti  
15 BIA ishte në varësinë e drejtpërdrejtë të komandës së zonës  
16 operative të Llapit dhe jo nën varësinë e ndonjë brigade të  
17 UÇK-së që vepronte në atë rajon.

18 Në intervistën e tij vullnetare me ZPS-në, i akuzuari e  
19 pranoi se ishte autoriteti më i lartë për ushtarët e BIA-s dhe  
20 kjo u konfirmua dhe nga anëtarë të tjerë UÇK-së që do të  
21 dëshmojnë në këtë gjykim, si dhe nga ndërveprimet midis të  
22 akuzuarit dhe vartësve të tij që i panë viktimat në këtë  
23 çështje.

24 Një numër i caktuar anëtarësh të njësimit BIA morën pjesë  
25 bashkë me të akuzuarin në ndalimin, keqtrajtimin dhe vrasjen

1 që ndodhi në prill të vitit 1999 në kompleksin e ndalimit në  
2 Zllash. Ju, të nderuar Gjykatës, emrat e këtyre vartësve do  
3 t'i dëgjoni nga vetë viktimat, të cilët dëgjuan emrat dhe  
4 nofkat e personave nga të cilët u mbajtën dhe torturuan gjatë  
5 kohës që u ndaluan në Zllash.

6 Krahas njësitit BIA, në atë zonë të njëjtë vepronin edhe  
7 disa njësi të tjera të UÇK-së. Njëra prej tyre ishte Brigada  
8 153, Hyzri Talla, që kishte fshatin Zllash dhe të gjithë  
9 rajonin e Gollakut brenda zonës së vet të përgjegjësisë.  
10 Shtabi i kësaj brigade ishte rreth 15 deri 20 minuta në këmbë  
11 prej kompleksit të ndalimit në Zllash. Provat do të tregojnë  
12 se kjo brigadë vepronte ndaras nga njësitit BIA dhe nuk kishte  
13 kurrfarë roli në drejtimin e kompleksit të ndalimit.

14 Të nderuar Gjykatës, nga korriku/gushti i vitit 1998 e  
15 deri së paku në fund të prillit 1999 njësitit BIA kishte në  
16 Zllash atë që i akuzuari përshkroi si "shtëpi e sigurtë" që  
17 ishte brenda kompleksit të ndalimit në Zllash. Zllashi është  
18 një fshat i vogël dhe i izoluar që gjendet afërsisht 10  
19 kilometra në lindje të Prishtinës në zonën malore të Gollakut.

20 Kërkoj nga sekretarja e sallës së gjyqit të na i tregojë  
21 diapozitivat 12 dhe 13.

22 Këto janë fotografi ajrore të kompleksit të ndalimit në  
23 Zllash të bëra në vitin 2006 nga misioni i Kombeve të  
24 Bashkuara në Kosovë, përkatësisht UNMIK-u. Në këtë diapozitiv  
25 mund të shihni një grup të vogël të vetëm, një grusht

1 ndërtesash që e përbënin kompleksin. Provat do të tregojnë se  
2 viktimat u mbajtën në një grup të vogël ndërtesash të lidhura  
3 njëra me tjetrën brenda kompleksit dhe si i akuzuari kaloi  
4 kohë në pjesën e sipërme të njëres prej këtyre ndërtesave ku  
5 mori në pyetje disa nga të ndaluarit. Të gjitha krimet e  
6 pretenduar në këtë çështje gjyqësore ndodhën brenda pikërisht  
7 këtij kompleksi paraqitur në këtë diapozitiv.

8 Tani të shikojmë diapozitivin numër 13, ju lutem.

9 Nëse tani e zvogëlojmë shkallën e fotografisë së  
10 kompleksit që e pamë në diapozitivin paraprak do të shihni  
11 sesa i izoluar ishte ky kompleks. S'ka asgjë përreth tij. Në  
12 njërin anë të këtij grupi të vogël ndërtesash ka mal dhe anën  
13 tjetër një rrugë. Duke pasur parasysh sa i vogël dhe i izoluar  
14 ishte kompleksi duhet të jetë e qartë se të ndaluarit që u  
15 kapën dhe u sollën në kompleks, ku u mbajtën të ndaluar, ishin  
16 të izoluar nga të gjitha anët dhe se personat e pranishëm në  
17 këtë kompleks në prill të vitit 1999, sigurisht, që duhet ta  
18 dinin se çfarë po ndodhte aty.

19 Le të flasim tani për një çast rreth konfliktit të  
20 armatosur që po ndodhte në kohën kur kanë ndodhur krimet e  
21 pretenduar në prill të vitit 1999, të nderuar Gjyqtarë.

22 Gjatë kësaj kohe dhe gjatë të gjithë periudhës së  
23 Aktakuzës ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar  
24 midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të Republikës  
25 Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, përfshirë

1 edhe njësitë e Ushtrisë Jugosllave, policisë edhe njësitë e  
2 tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si edhe grupe të  
3 tjera të cilat luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë. Nuk  
4 duhet të ketë asnjë pikë dyshimi lidhur me këtë fakt.

5 Konflikti karakterizohej nga një intensitet i lartë,  
6 kishte një sërë ofensivash të forcave jugosllave dhe serbe në  
7 shkurt dhe mars të 1999-s dhe me operacione me shkallë të  
8 gjerë të ndërmarrë në të gjithë Kosovën, përfshirë këtu edhe  
9 kundër forcave të UÇK-së të vendosura në rajonin e Gollakut në  
10 prill të vitit 1999.

11 Konflikti kishte karakter të zgjatur, ishte një konflikt  
12 me zanafillë në vitin 1998, shumë më herët sesa krimet e  
13 pretenduara në Aktakuzë e duke u shtrirë gjatë gjithë vitit  
14 1999, goxha më pas datave të këtyre krimeve.

15 Niveli i organizimit i palëve ndërluftuese ishte i  
16 mjaftueshëm për ta cilësuar atë si një konflikt të armatosur  
17 sipas ligjit ndërkombëtar. Forcat jugosllave edhe serbe ishin  
18 një ushtri e vërtetë e një shteti modern, e mirë-organizuar  
19 dhe e strukturuar me një komandë qendrore të unifikuar. Dhe  
20 UÇK-ja që vitin 1998 ishte një forcë e organizuar e armatosur  
21 nën një komandë përgjegjëse, kishte kontroll mbi pjesë të  
22 territorit të Kosovës dhe kishte aftësinë të kryente  
23 operacione ushtarake të qëndrueshme dhe të bashkërenduara. Ajo  
24 nxirrte rregullore të brendshme, urdhra dhe komunikata  
25 publike. Kishte një sistem të duhur raportimi dhe komunikimi

1 midis Shtabit të saj të Përgjithshëm dhe njësive të varura  
2 luftarake të tilla si brigadat, batalionet, kompanitë dhe  
3 skuadrave. Ajo ishte e ndarë në zona operacionale ku secila  
4 prej tyre kishte komandantin e vet. Ajo kishte furnizime me  
5 armë, kishte një sistem rekrutimi, kishte qendrat trajnimi, si  
6 edhe një sistem për të siguruar disiplinën ushtarake. Ushtarët  
7 e saj kishin uniforma, kishin gjithashtu edhe shenja të  
8 unifikuar të ushtrisë. Të gjithë këto elementë janë tregues të  
9 një pale të organizuar mjaftueshmërisht në konfliktin e  
10 armatosur, pozicion ky, të cilin UÇK-ja e kishte padyshim në  
11 kohën që është e rëndësishme për arsye të kësaj çështjeje.

12 Ka disa gjykime nga tribunalet ndërkombëtare penale  
13 p.sh., nga TPNJ-ja dhe nga Gjykatat e Kosovës të cilat kanë  
14 bërë konstatime përfundimtare në lidhje me ekzistencën e një  
15 konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë në prill të  
16 vitit 1999, përfshirë veçanërisht çështjet kundër  
17 Gjeorgjeviçit dhe Milutinoviçit në TPNJ. Dhe ju të nderuar  
18 Gjykatës, jeni informuar mbi konstatimet përkatëse për këto  
19 çështje në parashtrimet tona. Asnjë organ gjyqësor nuk e ka  
20 mohuar asnjëherë ekzistencën e atij konflikti të armatosur dhe  
21 askush që ka qenë në Kosovë gjatë asaj kohe nuk do ta  
22 kundërshtonte seriozisht ekzistencën e një konflikti të tillë.

23 Siç do të bëhet e qartë edhe gjatë gjykimit, krimet e  
24 akuzuara në këtë çështje kanë ndodhur në kontekstin dhe janë  
25 të lidhura me konfliktin e vazhdueshëm të armatosur midis UÇK-

1 së nga njëra anë dhe forcave të Republikës Federale Jugosllave  
2 dhe Serbisë nga ana tjetër. Këto krime janë kryer nga ushtarë  
3 në detyrë në kompleksin e Zllashit të përdorur si bazë nga  
4 njësia BIA. Vetë i akuzuari, komandanti i njësisë BIA, ishte i  
5 angazhuar gjatë kësaj periudhe në aktivitete të lidhura me  
6 konfliktin e armatosur. Sidomos, gjatë marrjes në pyetje, i  
7 akuzuari dhe vartësit e tij akuzonin viktimat si spiunë dhe  
8 kolaboracionistë. Ndërkohë që ishin të paqarta, të  
9 pavërtetuara dhe në fakt të pabazuara, këto akuza ishin një  
10 hallk së bashku me rrethana të tjera midis konfliktit të  
11 armatosur në vijim e sipër dhe krimeve të kryera nga i  
12 akuzuari dhe vartësit e tij.

13 Tani, më lejoni, të nderuar Gjykatës, t'i kthehem sërish  
14 ndërtesës brenda kompleksit të ndalimit në Zllash ku  
15 pretendohet të kenë ndodhur krimet e akuzuara në Aktakuzë.

16 Bëhet fjalë për një ndërtesë dykatëshe. Siç e pamë edhe  
17 më parë nga fotografitë e marra nga ajri, ndërtesa ishte pjesë  
18 e një grupi të vogël ndërtesash e izoluar nga çdo strukturë  
19 tjetër. Sot ky kompleks nuk ekziston më dhe prej tij ka mbetur  
20 vetëm një ndërtesë e vogël.

21 Të nderuar Gjykatës, më lejoni të tregoj disa foto të  
22 tjera të këtij kompleksi të bërë nga misioni i Kombeve të  
23 Bashkuara në Kosovë në prill të vitit 2006. Shpresoj që këto  
24 foto t'ju ndihmojnë për të kuptuar më mirë përbërjen dhe  
25 organizimin e atij vendi. Do të filloj sërish me foton e bërë

1 nga ajri të 2006-s që e përmenda pak më sipër.

2 Dhe do t'i kërkoja sekretares që të na tregonte  
3 diapozitivin e radhës, që mban numrin 14.

4 Ndërtesa e rrethuar, është ndërtesa ku kanë ndodhur  
5 krimet të cilat ngrihen si pjesë e Aktakuzës.

6 Ndërkohë tani le të shikojmë bashkarish diapozitivin  
7 numër 15.

8 Ky diapozitiv, të nderuar Gjykatës, përshkruan tre  
9 ndërtesa në kompleksin e ndalimit në Zllash, ku, sipas  
10 parashtrimeve të Prokurorisë, në prill të vitit 1999 janë  
11 mbajtur në mënyrë të paligjshme dhe janë keqtrajtuar disa të  
12 burgosur shqiptarë të Kosovës. Shigjeta me ngjyrë blu tregon  
13 dhomat në katin e epërm të përdorura nga pjesëtarët e BIA-s,  
14 si edhe nga i akuzuari, kur ata kanë qëndruar në Zllash.  
15 Shigjeta me ngjyrë të verdhë tregon një pjesë më të ulët të  
16 ndërtesës ku janë mbajtur të ndaluar viktimat.

17 Nuk e di në qoftë se sekretarja mund të vijoj me  
18 diapozitivin tjetër, diapozitiv i cili mban numrin 16.

19 Ky diapozitiv tregon të njëjtën ndërtesë nga një kënd  
20 tjetër. Ndërtesa të cilat tregohen në të majtë të kësaj  
21 fotografie është ndërtesa e cila është me interes për ne.  
22 Ndërkohë që shigjeta me ngjyrë blu e tregon ndërtesën për të  
23 cilën do të flasim në më tepër detaje.

24 Do t'i kërkoja sekretares që të na tregonte diapozitivin  
25 e radhës.



1 Kjo pamje na përshkruan ndërtesën kryesore ku pretendohet  
2 të ketë ndodhur keqtrajtimi i disa prej viktimave. Ata janë  
3 mbajtur në një podrum ose ahur në pjesën e poshtme të  
4 ndërtesës, në anën e majtë nga dera me shkallë, të treguar me  
5 shigjetën me ngjyrë të verdhë në fotografi. Dhe dërgoheshin me  
6 anë të shkallëve të brendshme në një vend në katin e sipërm,  
7 ku ata merreshin në pyetje dhe rriheshin. Ky vend shënjohej me  
8 shigjetën me ngjyrë blu. I akuzuari, vetë, po ashtu ka dhënë  
9 një përshkrim të hollësishëm të kësaj ndërtese.

10 Të nderuar Gjykatës, ju do të shikoni gjithashtu të  
11 njëjtën ndërtesë në fotografi që do të tregohen nga Mbrojtja,  
12 njëra prej këtyre fotove do të jetë fotografia që do t'jua  
13 tregojmë tani në diapozitivin 18.

14 Pra, për këtë diapozitiv e kam fjalën posaçërisht, të  
15 nderuar Gjykatës. Në këtë diapozitiv ndërtesa është në anën e  
16 majtë të fotografisë. Shigjetat me ngjyrë blu dhe të verdhë  
17 tregojnë përkatësisht vendin e përdorur nga BIA gjatë marrjes  
18 në pyetje dhe keqtrajtimit të viktimave dhe vendin ku  
19 mbaheshin viktimat që është pjesa e ndërtesës që tregohet me  
20 shigjetë të verdhë.

21 Ndërtesa më e vogël aty ngjitur, një ahur prej druri, me  
22 një dhomë trekëndore të mbuluar me tjegulla të kuqe, është e  
23 vetmja ndërtesë e cila ka mbetur në terren sot e kësaj dite.

24 Ish-pjesëtarë të Brigadës 153 të UÇK-së të vendosur në  
25 Zllash do të dëshmojnë se në vitin 1999 ky kompleks ishte

1 ekskluzivisht i përdorur dhe i zënë nga njësia BIA, e cila  
2 ishte nën komandën e të akuzuarit. Vetë i akuzuari ka dëshmuar  
3 se ai ka qenë shpesh në Zllash në periudhën e prillit dhe  
4 marsit të vitit 1999. ZPS-ja do të parashtrojë prova nga disa  
5 dëshmitarë, të cilët e vendosin, gjithashtu, të akuzuarin në  
6 kompleksin e ndalimit në Zllash në kohë të ndryshme kritike  
7 për këtë çështje.

8 Tani mund ta mbyllim prezantimin në PowerPoint dhe  
9 vijojmë me pjesën tjetër të parashtrimit të Prokurorisë.

10 Tani, të nderuar Gjykatës, do të doja të tërhiqja  
11 vëmendjen tuaj në provat materiale që do të jepen dhe në  
12 fillim do të doja të thosha që Mbrojtja ka parashtruar dy  
13 Mbrojtje për të ndaluarin. Së pari ka bërë njoftim për alibi.

14 Kur ju, të nderuar Gjykatës, do të dëgjoni provat lidhur  
15 me alibinë, mbase do të mund t'i bëni pyetjen vetes se pse i  
16 akuzuari po përpiqet të pretendojë se ai nuk ka qenë i  
17 pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash në kohët e  
18 caktuara. Sipas nesh arsyeja është sepse provat do të tregojnë  
19 se në fakt krimet e pretenduara prej nesh kanë ndodhur  
20 realisht atje dhe se tani i akuzuari po përpiqet të largohet  
21 sa më shumë të jetë e mundur prej tyre. Të nderuar Gjykatës,  
22 ju do të duhet që të vlerësoni provat e Prokurorisë dhe të  
23 Mbrojtjes, për të vlerësuar nëse vërtet ka një alibi apo jo.  
24 Ne parashtrojmë se si Prokuroria ashtu edhe prova të caktuara  
25 të Mbrojtjes e vendosin të akuzuarin në Zllash në kohë të

1 caktuara gjatë 20 ditëve të para të prillit të vitit 1999,  
2 periudhë e cila është e rëndësishme për këtë çështje. Për më  
3 tepër, provat do të dëshmojnë se kur ai nuk ka qenë në Zllash,  
4 ai ka qenë në vende të cilat ishin lehtësisht të arritshme për  
5 pak orë me makinë ose me këmbë.

6 Në fund të ditës, asnjë prej provave të alibisë të  
7 Mbrojtjes nuk i hedh poshtë në asnjë mënyrë akuzat e  
8 parashtruara në Aktakuzë. Alibia e propozuar nuk ofron as  
9 mburojë faktike dhe as mburojë ligjore për përgjegjësinë  
10 penale.

11 Përveç paraqitjes së të ashtuquajturës alibi nga  
12 Mbrojtja, Mbrojtja gjithashtu pretendon se krimet në Zllash  
13 thjesht nuk kanë ndodhur fare, asnjëherë. Pra, ata pretendojnë  
14 që nuk ka pasur asnjë arrestim, asnjë të burgosur, asnjë  
15 person të mbajtur, asnjë marrje në pyetje, asnjë rrahje, asnjë  
16 keqtrajtim, asnjë abuzim. Sipas tyre asnjëra prej këtyre  
17 krimeve nuk ka ndodhur. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses, do të  
18 dojë të marrë parasysh provat nga të gjithë dëshmitarët,  
19 përfshirë deklaratat e të akuzuarit si dhe sjelljen e të  
20 akuzuarit gjatë hetimit të këtyre krimeve. Ne parashtrojmë se  
21 provat nuk do të lënë asnjë pikë dyshimi se këto krime kanë  
22 ndodhur dhe se i akuzuari ka qenë përgjegjës për to.

23 Tani më lejoni të flas pak për krimet e pretenduara dhe  
24 viktimat të cilat janë dërguar në kompleksin e ndalimit në  
25 Zllash, janë ndaluar në mënyrë të paligjshme atje, në kushte

1 të mjerueshme, janë marrë në pyetje dhe kanë qenë objekt i  
2 llojeve të ndryshme të keqtrajttimeve brutale thuajse çdo ditë.  
3 Këto viktima ishin të gjithë vendas, ishin shqiptarë të  
4 Kosovës dhe askush prej tyre nuk merrte pjesë në sulmet aktive  
5 në kohën kur janë arrestuar, rrahur dhe vrarë. Gjatë marrjes  
6 së tyre në pyetje të ndaluarit janë akuzuar se ishin spiunë,  
7 kolaboracionistë me serbët ose hajdutë. Realiteti është që, në  
8 fakt, askush prej këtyre burrave nuk përbënte kërcënim  
9 ushtarak për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Disa po  
10 përpiqeshin që të nxirrnin jetesën duke shitur mallra në  
11 tregjet lokale. Të tjerë ishin civilë, faj i vetëm i të cilëve  
12 ishte se përkisnin një partie tjetër politike, Lidhjes  
13 Demokrate të Kosovës, LDK-së, e cila perceptohej nga disa  
14 anëtarë të UÇK-së si kundërshtarë politike.

15 Të nderuar Gjykatës, ne do të dëgjojmë prova sesi viktima  
16 të ndryshme janë arrestuar dhe janë dërguar në kompleksin e  
17 ndalimit në Zllash përfshirë prova edhe nga disa prej  
18 viktimave. Ata do t'ju tregojnë për organizimin e kompleksit  
19 do t'ju tregojnë sesi janë mbajtur atje dhe kë tjetër ata kanë  
20 njohur ndërsa qëndronin në Zllash. Ju do të dëgjoni se  
21 pavarësisht akuza të pabaza të bërë gjatë marrjes në pyetje,  
22 atyre nuk u është thënë asnjëherë se pse ishin arrestuar apo  
23 ndaluar. Atyre nuk është dhënë asnjëherë asnjë dokument  
24 arrestimi apo lirimi.

25 Ju do të dëgjoni vetë sesi viktimat janë detyruar të

1 flenë në dysheme në një haur kafshësh duke ju dhënë ushqim dhe  
2 ujë të pamjaftueshëm dhe të mbajtur në kushte jashtëzakonisht  
3 jo higjienike. Asnjë kujdes mjekësor nuk u është ofruar atyre  
4 për të shëruar plagët e shkaktuara nga i akuzuari dhe vartësit  
5 e tij gjatë seancave të shpeshta të marrjes në pyetje dhe  
6 rrahjes.

7 Viktimat do t'ju tregojnë vetë për marrjet në pyetje dhe  
8 rrahjet do t'ju tregojnë se kush ka marrë pjesë në to. Do t'ju  
9 tregojnë se cilët janë instrumentet e përdorura për t'i  
10 sulmuar ata. Ju do të mësoni prej tyre se çfarë pyetjesh ju  
11 janë bërë viktimave dhe çfarë akuzash ngriheshin ndaj tyre. Ju  
12 do të dëgjoni për kërcënimet që ju janë bërë atyre si dhe për  
13 sjelljen që shkon deri në nivelin e torturës.

14 Do të dëgjoni gjithashtu në mënyrë specifike mbi rolin e  
15 të akuzuarit në disa marrje në pyetje dhe rrahje që ai ka  
16 mbikëqyrur vetë, ka drejtuar dhe ka marrë pjesë. Viktimat do  
17 të dëshmojnë se ata mund të dëgjonin kur të tjerët rriheshin  
18 dhe do t'ju tregojnë për dëmtimet e rënda fizike dhe  
19 psikologjike të pësuar, disa prej të cilave vazhdojnë të kenë  
20 pasoja mbi viktimat edhe sot e kësaj dite.

21 Provat do të tregojnë se një viktimë u veçua për abuzim  
22 të posaçëm të egër dhe ka pësuar lëndime veçanërisht të rënda.  
23 Kur viktimat u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash më 19  
24 prill 1999 për shkak të avancimit të ofensivës serbe, ky i  
25 burgosur dhe një tjetër nuk u lejuan të largoheshin. Asnjëri

1 prej tyre nuk u pa më kurrë i gjallë. Pak kohë më vonë, pas  
2 një kërkimi intensiv dhe të dhimbshëm nga familjarët, trupi i  
3 viktimës së keqtrajtuar rëndë u gjet në një varr të cekët në  
4 një distancë shumë të shkurtër larg kompleksit të ndalimit në  
5 Zllash së bashku me një trup të dytë.

6 Në bazë të këtyre fakteve, Aktakuza në këtë çështje e  
7 akuzon të akuzuarin për krimet e luftës të ndalimit të  
8 paligjshëm, trajtimit mizor dhe torturës dhe vrasje të  
9 paligjshme të viktimës të rrahur rëndë, i cili nuk u lejua që  
10 të largohet nga kompleksi dhe trupi i të cilit u gjend pak  
11 kohë më vonë.

12 I akuzuari është përgjegjës për krimet e kryera në  
13 kompleksin e ndalimit në Zllash përmes pjesëmarrjes së vet në  
14 to në bashkëpunim me vartësit e tij. I akuzuari menaxhonte  
15 kompleksin dhe siç e ka pranuar edhe vetë, ai kishte  
16 kompetenca të plota mbi pjesëtarët e BIA-s të pozicionuar  
17 atje. Ai ka marrë pjesë personalisht në marrjet në pyetje dhe  
18 në rrahje. Ai kishte kompetenca të parandalonte keqtrajtimin e  
19 tyre dhe t'i lironte ata, por ai nuk bëri asnjërin prej këtyre  
20 derisa u detyrua të evakuonte kompleksin për shkak të  
21 përparimit të forcave serbe dhe jugosllave.

22 Përveç drejtimit, mbikëqyrjes, pjesëmarrjes në krimet e  
23 pretenduara, i akuzuari kishte njohuri të bollshme mbi to. Ai  
24 flinte në të njëjtën shtëpi ku mbaheshin edhe të burgosurit.  
25 Klithmat nga vuajtja gjatë marrjes në pyetje dhe rrahjet, të

1 cilat përgjithësisht ndodhnin në katin e epërm të ndërtesës,  
2 ku qëndronte zakonisht i akuzuari, ishin aq të forta sa mund  
3 të dëgjoheshin nga të burgosur të tjerë një kat më poshtë.  
4 Trupat e të ndaluarve e shfaqnin shenja të dukshme keqtrajtimi  
5 që ata kishin pësuar.

6 Kjo është një përmbledhje e provave që do të parashtrohen  
7 në këtë çështje. Siç e thash; edhe në fillim të komenteve të  
8 mia, kjo çështje është e drejtpërdrejtë dhe e thjeshtë. Krimet  
9 janë kryer nga i akuzuari dhe nga vartësit e tij gjatë një  
10 periudhe disa javore në prill të vitit 1999 në një kompleks të  
11 kontrolluar të vogël dhe të izoluar në Zllash. I akuzuari ka  
12 qenë i pranishëm atje, ai ka qenë përgjegjës dhe ai është në  
13 fund përgjigjes për krimet e ndodhura atje.

14 Për këto arsye, në fund të çështjes, ne do të kthehemi  
15 përsëri përpara jush, të nderuar Gjykatës, për t'ju kërkuar  
16 për ta deklaruar të akuzuarin fajtor për krimet e akuzuara në  
17 Aktakuzë.

18 Ju faleminderit shumë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, z. prokuror.

21 Tani po shikoj orën. Është ora 11 pa një çerek. Propozoj,  
22 edhe Mbrojtësit të Viktimave, që të bëjmë një pushim prej  
23 gjysëm ore tani deri në orën 11.15 dhe pastaj të rifillojmë  
24 dhe ju të filloni me deklaratën tuaj hapëse.

25 Ndërpritet tani seanca dhe shihemi përsëri në orën

1 11.15.

2 --- Pauza fillon në orën 10.45

3 --- Seanca rifillon në orën 11.41

4 [I akuzuari nuk është i pranishëm]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni  
6 ju lutem.

7 Mirë se keni ardhur përsëri. Po, përpara se të kalojmë te  
8 deklaratat hapëse të Avokatit të Viktimave, kemi diçka që  
9 duhet ta themi. Klienti juaj nuk dëshiron të jetë më i  
10 pranishëm sot këtu. E di që ka një procedurë dhe shoh që ju po  
11 pohoni me kokë dhe është rregulla 68(4) e Rregullores, me  
12 kusht që të gjitha kushtet e paragrafit 4 të plotësohen, i  
13 akuzuari mund të refuzojë të qëndrojë i pranishëm.

14 Dëshironi të bëni ndonjë parashtim në këtë drejtim?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, faleminderit  
16 shumë. Në fakt siç ma sqaroi i akuzuari, nuk dëshiron të  
17 qëndrojë më në këtë seancë. Nuk ka ndonjë parashtim të  
18 veçantë për këtë. Kështu është, kështu ndodhi.

19 Besoj që për këtë seancë nuk do të rrijë por pres që të  
20 jetë përsëri këtu të hënën. Kaq mund të them. Sigurisht unë do  
21 të jemi i pranishëm si gjithmonë. Pra, nuk e di nëse -- . Jo,  
22 jo. Është e qartë se thjesht më tha që nuk do të qëndrojë më i  
23 pranishëm sot.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
25 t'ju bëj disa pyetje për këtë gjë dhe edhe në rastin që nuk



1 parashikohet nga Rregullorja, unë do t'ia jap fjalën  
2 Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Viktimave për të folur nëse ka  
3 nevojë.

4 Por përpara se të bëj këtë dua të kalojmë disa nga  
5 kushtet e parashikuara në paragrafin 4. Sigurisht është bërë  
6 paraqitja fillestare. Zoti Mustafa është në dijeni të faktit  
7 që në parim prania e tij është e nevojshme. Ai nuk është këtu  
8 por në parim kërkohet që të rrijë. Dhe një pjesë shumë e  
9 rëndësishme është që ai ka hequr dorë nga e drejta për të qenë  
10 i pranishëm me vullnetin e tij të lirë.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, ai hoqi dorë nga e drejta e  
12 tij për të qenë këtu i pranishëm në mënyrë pa ekuivok gjatë  
13 seancës së sotme. E di që parashikohet e drejta për t'u  
14 gjykuar. Nuk e di se si është formuluar konkretisht kjo  
15 dispozitë, por --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë e  
17 hapa sot seancën dhe faktikisht është gjyqi ky që po  
18 zhvillojmë dhe për këtë nuk ka diskutim. Një gjë tjetër që ka  
19 rëndësi për mendimin tim është që ju do të jeni i pranishëm  
20 dhe e konfirmoni këtë?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Absolutisht, po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
23 do të përfaqësoni interesat e tij?

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Pa dyshim

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] dhe

1 pastaj varet nga Trupi Gjykses nëse është e nevojshme që ai të  
2 jetë këtu i pranishëm për këtë seancë.

3 Tani i jap fjalën Prokurorisë.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, preferenca  
5 jonë si Prokurori është që i akuzuari të ishte i pranishëm,  
6 por ne ja lemë vendimit Trupit Gjykses siç parashikohet nga  
7 rregulla 64(4).

8 Në fakt ne duam që të kemi një proces verbal të qartë  
9 lidhur me faktin se i akuzuari, sipas rregullës 64(4)(c), me  
10 vullnetin e tij dhe në mënyrë të pa diskutueshme ka hequr dorë  
11 nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm. Këtë duhet ta  
12 shkruajmë mirë dhe qartë në proces verbal që ta kemi për të  
13 ardhmen nëse diçka del më vonë. Për shembull gjatë procedurave  
14 mund të thuhet se i akuzuari është privuar nga e drejta për të  
15 qenë i pranishëm. Këtë gjë e bëri me vullnetin e tij të lirë,  
16 në mënyrë të vetëdijshme, e hoqi të drejtën e tij duke e ditur  
17 se procedura -- procesi do të vazhdojë dhe se interesi i tij  
18 do të përfaqësohet nga mbrojtësi.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, zoti Prokuror.

21 Këto pyetje i janë bërë Prokurorit të Specializuar dhe ai  
22 i ka pohuar. Pra këtë e kemi shkruar në proces verbal.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni, besoj që Prokurori i  
24 Specializuar e ka fjalën për rregullën 68, jo rregullën 64.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

1 dëgjova edhe unë. Po flasim në fakt për rregullën 68,  
2 paragrafi 4.

3 Mbrojtësja e Viktimave, keni ndonjë parashtrim

4 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, kam. Pikë së pari, lidhur me  
5 rregullën 68, parimet e qarta të parashikuara në to kanë të  
6 bëjnë me praninë e të akuzuarit. Po të shohim paragrafin 1  
7 thuhet:

8 "Ai gjykohet në praninë e tij".

9 Ne për mendimin tonë, ky është një mospërfillje e qartë  
10 dhe mungesë respekti për viktimat që ai largohet. Por ky është  
11 parimi, siç thashë, dhe qëllim i rregullës është që të jetë i  
12 pranishëm i akuzuari.

13 Kur i akuzuari është i lirë, ai duhet të tregojë arsye të  
14 forta për t'u përjashtuar. Në qoftë se ai nuk është i lirë që  
15 ta bëjë këtë dhe kjo paraqitet në paragrafin 4, nën kushtet  
16 nën nën-paragrafin (a) deri në (e) janë akumulative, sipas  
17 interpretimit tim, sepse në fund të paragrafit (d) thuhet  
18 qartë se të gjitha këto kushte duhen plotësuar.

19 Në fund, do të jetë në diskrecionin tuaj si Trup Gjykues  
20 nëse prania e të akuzuarit nuk është e pranishme për këtë  
21 seancë konkrete për të marrë vendim, për ta urdhëruar apo jo  
22 të akuzuarin që të jetë i pranishëm. Unë do të doja prej jush  
23 që të kishit parasysh që mos kjo gjë ndodh çdo ditë që  
24 akuzuari të vendosë nëse do të rrijë apo jo, me qëllim që për  
25 shembull, dëshmitarët që do të paraqiten, për të cilët kjo

1 është një ngjarje shumë traumatizuese, të mos kenë as  
2 mundësinë për t'iu përgatitur nëse do të përballen me të  
3 akuzuarin e pranishëm këtu, që është një çështje në fakt shumë  
4 ndryshe nga mosprania e tij.

5 Dhe mjedisi i Gjykatës që është shumë i rëndësishëm për  
6 ta. Dhe në përfundim mund të them se prania, e gjykimi i një  
7 të akuzuari është i qartë shumë mirë me drejtësinë e  
8 procedurave dhe një gjykim i drejtë ka të bëjë me të drejtën e  
9 të akuzuarit. Por drejtësia e procedurave lidhet gjithashtu me  
10 perceptimin që ka bota jashtë Gjykatës dhe me legjitimitetin e  
11 Gjykatës, me mënyrën se si perceptohet kjo Gjykatë.

12 Prandaj mendoj se ka rëndësi që kjo Gjykatë të theksojë  
13 që në fillim se kur ju të nderuar Gjykatës do të formësoni  
14 praktikën gjyqësorë jo vetëm të këtij gjyqi por edhe të  
15 procedurave të proceseve të ardhshme, qëndrimi juaj automatik  
16 duhet të jetë në favor të qëndrimit të pranisë së të  
17 akuzuarit, që të mos bëhet në fakt gjykim i tij në mungesë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit shumë.

20 Kemi nevojë për një raund tjetër?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të trajtoj dy çështje që i  
22 preku kolegja.

23 Është një praktikë e zakonshme që në të gjitha seancat që  
24 kemi pasur deri tani, i akuzuari mundet ose jo të jetë i  
25 pranishëm. Pra mund të heqë dorë nga prania e tij duke vënë në

1 dukje dokumentin që parashtrohet çdo herë përpara procedurave  
2 për procesin. Pra, nuk mendoj se çështjet kumulative që  
3 përmendi kolegja e nderuar janë të natyrës kumulative vërtetë.  
4 Pra nuk besoj se ka nevojë të jepet një vendim për këtë dhe  
5 pastaj ai përfaqësohet nga një mbrojtës që mbron interesat e  
6 tij dhe pastaj varet nga i akuzuari se si do të procedohet më  
7 tej.

8 Unë i kuptoj ndjenjat e Mbrojtjes së Viktimave lidhur me  
9 viktimat. Nuk mund të them thjesht se do të jetë një standard,  
10 një gjë e zakonshme kjo gjë. Këtë nuk e them dot, por sot  
11 ndodhi kështu siç ndodhi dhe nuk mund të them diçka për të  
12 ardhmen.

13 Çdo herë do të ketë një dokument që do të parashtrohet  
14 nëse i akuzuari do të jetë apo jo i pranishëm apo do të jetë i  
15 pranishëm përmes video lidhjes. Këto janë gjërat që desha të  
16 theksoja lidhur me ato që tha kolegja.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që ta  
18 përmbledh këtë që thatë, doni të thoni me shpjegimin e  
19 paragrafit 4 se nuk është kumulativ?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Ashtu është. Po. Prania nuk  
21 kërkohet.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
23 jo, mbase nuk po e kuptojmë njëri tjetrin. Kumulativ do të  
24 thotë në kuptimin që ai duhet ta ketë bërë paraqitjen  
25 fillestare, që ka ndodhur dhe duhet të njoftohet përkatësisht

1 që duhet të jetë këtu, që është njoftuar dhe në këtë rast e ka  
2 hequr dorë nga e drejta se ju do të jetë këtu dhe pastaj është  
3 Trupi Gjykses që është i nevojshëm. Doni të thoni me këtë  
4 kërkesën e fundit se nuk është kumulativ?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë e kuptova ndryshe. Ai, e  
6 nderuara kolege, citoi rregullën 68. Faktikisht është 68(4) që  
7 është kumulative.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
9 ju kuptoj --

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Rregulla 68(4) -- këto çështje  
11 janë çështje kumulative. Nga a-ja deri te e-ja. Jo nga 1 deri  
12 6.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
14 iu përgjigjët pyetjes. Pra kushtet e parashikuara në  
15 paragrafin 4, nga pika a deri te pika e, i konsideroni  
16 kumulative.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
19 i kthehem përsëri ZPS-së.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar. Ju  
21 faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
23 do të konsultohem me kolegët e mi por nuk do ta bëjmë këtë  
24 këtu. Do të kthehem. Nuk do t'ju lemë që të prisni shumë  
25 gjatë, por mendoj që këtë duhet ta bëjmë jashtë sallës së

1 gjyqit. Ju faleminderit. E ndërpresim seancën për një kohë të  
2 shkurtës.

3 Të gjithë në këmbë.

4 --- Pauza fillon në orën 11.55

5 --- Seanca rifillon në orën 12.08

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni  
7 ju lutem.

8 Tani do të jap një urdhër gojor në përputhje me rregullën  
9 68(4) të Rregullores.

10 Theksoj që në këtë çështje ka pasur një paraqitje të  
11 parë. I akuzuari është njoftuar në mënyrën e duhur dhe ai  
12 duhet të jetë i pranishëm. Ai në mënyrë vullnetare ka hequr  
13 dorë nga e drejta e të qenit i pranishëm dhe avokati i tij  
14 është i pranishëm dhe do të përfaqësojë interesat e tij gjatë  
15 kësaj seance dhe në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje,  
16 Trupi Gjykses është i mendimit se prania e të akuzuarit është  
17 e nevojshme edhe pse jo e nevojshme në këtë rast. Megjithatë,  
18 ky refuzim për t'u paraqitur dhe zoti Von Bone kjo lidhet me  
19 pjesën e mbetur të seancës së sotme. Gjykata e mban të drejtën  
20 e vet diskrecionale në të ardhmen që ta detyrojë të akuzuarin  
21 që të jetë i pranishëm dhe kur ai heq dorë nga kjo e drejtë.

22 Me kaq përfundon urdhri gojor.

23 Zonja sekretare, ju mund ta informoni sigurimin që mund  
24 të vazhdojmë me organizimin e kthimit të të akuzuarit në  
25 objektin e paraburgimit.

1 Dhe zoti Von Bone, edhe një çështje tjetër që dua ta  
2 disskutoj me ju në këtë moment. Duhet ta informoni klientin  
3 tuaj që nuk do të lejojmë zotin Mustafa në seancat në të  
4 ardhmen që të përdorë gjuhë pa kurrfarë respekti në lidhje me  
5 palët apo pjesëmarrësit e tjerë në këtë procedurë, siç ishte  
6 gjuha që përdori klienti juaj kur ju referua ZPS-së.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Sigurisht që do t'ia përcjell  
8 këtë informacion, e nderuar Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 faleminderit.

11 Mendoj që erdhi koha që ju, Mbrojtësja e Viktimave, të  
12 bëni deklaratën tuaj hyrëse. Urdhëroni, ju lutem.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Zyra e  
14 Prokurorisë, Mbrojtja dhe të gjithë që mbase janë duke i  
15 ndjekur këto procedura sot.

16 E vëmë në dukje mungesën e të akuzuarit, sigurisht dhe  
17 nuk i drejtohem dot direkt atij siç kisha ndërmend përpara  
18 sepse në fakt ka shumë rëndësi që të kemi një farë angazhimi  
19 me njëri-tjetrin.

20 Unë këtë e shoh si shenjë mungese respekti. Megjithatë,  
21 rëndësi ka që të themi sot ato që kanë rëndësi nga  
22 këndvështrimi i viktimave dhe duhet të them që ky është një  
23 moment shumë i veçantë për të gjitha këto viktima që marrin  
24 pjesë në këto procedura. Është një moment për të cilin në Hagë  
25 të gjithë kanë pritur dhe të gjithë shpresojnë që më në fund



1 të shohin vënien në vend të drejtësisë.

2 Kanë kaluar 22 vite pas ngjarjeve të përjetuara nga  
3 viktimat, të cilëve ne do t'u japim zë dhe do të përfaqësojmë,  
4 të cilat do tua ndryshonin jetën. Unë i kam takuar dhe kam  
5 folur me të gjithë ata dhe të gjithë këto viktimë pjesëmarrëse  
6 dhe të gjitha takimet tregonin pikëllim dhe trauma dhe asnjë  
7 nga plagët e shkaktuara në vitin 1999 nuk janë shëruar.  
8 Fizikisht disa mund të ishin shëruar, në disa të tjerë kanë  
9 lënë shenja, gunga në kokë, shtrembërime të gjymtyrëve, apo  
10 dëmtime në shikim. Por asnjë nga plagët e padukshme, ato të  
11 shkaktuara në shpirt, nuk kanë pasur mundësinë të shëroheshin.  
12 Përkundrazi, këto lëndime kanë errësuar shumë aspekte të jetës  
13 së tyre, kanë mjegulluar të gjitha çastet e tjera, të cilat  
14 normalisht duhej të kishin sjellë gëzim dhe lumturi në jetën e  
15 njeriut.

16 Personalisht jam befasuar sesa e pranishme trauma, sa e  
17 dukshme frika dhe frikësimi i të gjithë viktimave që janë  
18 pranuar të marrin pjesë në këto procedura.

19 Të nderuar Gjykatës, e dëgjuam paraqitjen e provave të  
20 Prokurorisë. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka paraqitur  
21 krimet e kryera në Zllash. Dhe ne as nuk do të përsërisim  
22 aktakuzën, as provat e Prokurorisë. Ne do të trajtojmë në fakt  
23 çështjet e mëposhtme.

24 Së pari, do të fokusohemi në kuptimin e këtyre  
25 procedurave për viktimat që ne përfaqësojmë këtu, për t'u

1 mundësuar ju të gjithë një ide më të mirë të interesave,  
2 pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre. Pastaj, do të flasim për  
3 nevojat për drejtësi, për të vërtetë dhe për reparacione. Dhe  
4 së fund, do ta përfundojmë deklaratën tonë hapëse me zërat e  
5 viktimave pjesëmarrëse, dëshirat dhe vizionet e tyre për të  
6 ardhmen dhe të shpresojmë se kjo është shpresa ime e sigurtë,  
7 do të mund të kontribuojmë në ato dëshira dhe do të punojmë  
8 për t'i bërë ato realitet.

9 Me këtë po kalojmë te kuptimi i këtyre procedurave për  
10 viktimat. Mund të them se zhgënjimi i viktimave është i madh.  
11 Ata kanë pritur shumë gjatë dhe janë lodhur nga premtimet e pa  
12 mbajtura. Viktima që kanë vuajtur në duart e UÇK-së kanë  
13 dështuar sepse nuk kanë pasur asnjë rast të kërkojnë zgjidhje  
14 efikase për vuajtjet e tyre. Në asnjë Gjykatë të brendshme,  
15 hibride apo ndërkombëtare.

16 Dhe sigurisht kjo tregon se pse ishte e nevojshme që  
17 ngrihej kjo Gjykatë dhe puna e kësaj Gjykate do të ishte rasti  
18 i fundit për ta bërë këtë, për të gjetur zgjidhje dhe drejtësi  
19 për ta.

20 Kjo më shpie pastaj te thirrja që i bëj Trupit Gjykses që  
21 cili do vendim që mund të merrni në këtë Gjykatë, qëllim  
22 kryesor duhet të jetë dhënia e drejtësisë tani. Asnjë vendim  
23 nuk duhet marrë bazuar në aspekte të ekonomisë gjyqësore apo  
24 pragmatizmit. Përkundrazi, në çdo vendim që ky Trup Gjykses do  
25 të marrë gjatë këtij procesi, prova duhet të jetë se cili

1 është vendimi që do të sigurojë më mirë vënien në vend të  
2 drejtësisë tani. Për viktimat që marrin pjesë në këto  
3 procedura gjyqësore është me rëndësi që të arrihet një farë  
4 mbyllje dhe të mendojnë se pritja e tyre po merr fund.

5 Po ka edhe një dimension tjetër që i jep shumë rëndësi  
6 këtij gjykimi. Është heshtja që rrethon krimet e kryera nga  
7 luftëtarët e UÇK-së. Një vello heshtjeje ka mbuluar disa nga  
8 krimet e kryer gjatë luftës në Kosovë. Viktimat që marrin  
9 pjesë këtu kanë qenë të heshtur dhe i kanë detyruar të heshtin  
10 gjatë gjithë këtyre viteve. Ata jetojnë në një vend ku në  
11 shumë vende UÇK-ja kremtohet si hero, ku trysnia është  
12 jashtëzakonisht e lartë për të mos bërë pyetje të cilat do të  
13 prishnin imazhin e ndritur të heronjve.

14 Ky gjyq mund të jetë një mundësi, një shans për të  
15 filluar pak nga pak një bashkëbisedim për të lejuar dialogun  
16 në Kosovë të kuptojë plotësisht atë që ka ndodhur gjatë  
17 luftës. Ky është një shans për të shpuar vellon e heshtjes që  
18 rrethon këto krime. Është një shans i rëndësishëm edhe për  
19 brezat e ardhshëm në Kosovë dhe përtej saj, për të pasur një  
20 ide më të plotë të historisë së tyre, për të mësuar dhe për të  
21 kuptuar.

22 Edhe sot që flasim, historia e pabarabartë e luftës  
23 përcakton perceptimet në Kosovë. Ky gjyq është një mundësi e  
24 rëndësishme për të trajtuar këtë mungesë barazie, për shkak se  
25 ky është një aspekt i rëndësishëm i këtij gjykimi më lejoni të

1 shpjegoj se për se narrativa aktuale e luftës në Kosovë në  
2 vitin 1999 është e pa balancuar.

3 11,609, nga 13,535 viktima të kësaj lufte, kanë qenë  
4 civilë. Një pjesë e tyre ishin viktima të drejtpërdrejtë të  
5 luftëtarëve të UÇK-së. Ky grup viktimash, megjithatë,  
6 sistematikisht është marginalizuar. Në shumë nivele ata nuk  
7 kanë qenë dhe nuk janë trajtuar dhe nuk trajtohen si të  
8 barabartë me ata që kremtohen si martirë, invalidë, veteranë,  
9 dhe anëtarë të UÇK-së. Kjo lë një pjesë shumë të madhe të  
10 historisë të pa rrëfyer, të papranuar. Zërat e viktimave janë  
11 mbyllur nga frika e shpagimit dhe e marginalizimit të  
12 mëtejshëm.

13 Ata nuk janë viktimizuar vetëm një herë gjatë krimeve të  
14 kryera gjatë luftës, por kanë vuajtur edhe pas lufte, duke u  
15 lënë plotësisht vetëm. Drejtpërdrejtë apo indirekt, ata janë  
16 frikësuar dhe u kanë mbyllur gojën për dekada. Frikësimi i  
17 atyre që ngritën zërin kundër kryerësve shqiptarë ka qenë një  
18 problem në procese përpara TPNJ-së në Gjykata hibride si dhe  
19 në procedurat e EULEX-it.

20 Në rastet kundër kryerësve serbëve, nuk ka ndodhur  
21 frikësimi. Në ndryshim nga kjo, personat kanë dalë dhe i kanë  
22 treguar historitë e tyre përpara publikut. Viktimat e regjimit  
23 serb kishin platformën për të treguar historitë e tyre hapur  
24 dhe kanë marrë simpatinë e pjesës tjetër të popullsisë, ndërsa  
25 viktimat e luftëtarëve të UÇK-së edhe sot që flasim duhet të

1 jetojnë me frikë dhe të përballen me apatinë shoqërore ndaj  
2 tyre. Dhe kërkon shumë kurajë që viktimat të marrin pjesë këtu  
3 dhe dëshmitarët të dëshmojnë në këto procedura gjyqësore dhe  
4 të ndihmojnë për të korigjuar pamjen e paplotë të luftës së  
5 Kosovës.

6 Kjo pabarazia që kam përmendur dhe për të cilën po flas,  
7 pasqyrohet edhe në legjislacionin e brendshëm. Një shembull  
8 ilustrues është ligji për statusin e të drejtat e martirëve,  
9 invalidëve, veteranëve, anëtarëve të UÇK-së, viktimave civile  
10 të luftës dhe familjeve të tyre. Ky ligj, i cili njihet  
11 gjerësisht si ligji për reparacionet e luftës, ofron qasje në  
12 reparacione për kategori specifike njerëzish.

13 Sipas këtij ligji, një viktimë civile e luftës është një  
14 person i cili ka vdekur apo është plagosur nga forcat e  
15 armikut nga 27 shkurti i vitit 1998 deri në qershor të vitit  
16 1999. Robi civil i luftës është një person civil që gjatë  
17 luftës është arrestuar dhe burgosur në kampet e armikut për të  
18 paktën tre ditë.

19 Dhe ky përdorim i fjalës "armik" në thonjëza që gjendet  
20 në ligj, i njëjti ligj që i konsideron anëtarët e UÇK-së si  
21 martirë, përjashton çdo viktimë të krimeve të kryera nga  
22 luftëtarët e UÇK-së. Viktimave të luftëtarëve të UÇK-së pra u  
23 mohohet njohja apo një pension modest që parashikon ky ligj.

24 Kryesisht situata mund të përmbledhet si më poshtë: në  
25 qoftë se dikush është në viktimë e regjimit serb nxitet të

1 dalë dhe të flasë, të tregojë historinë e vet, nxitet të  
2 kërkojë drejtësi, nxitet të kërkojë kompensime, por nëse është  
3 një viktimë ndaluar arbitrarisht, torturuar dhe vrarë në duart  
4 e UÇK-së, vuajtja e tyre injorohet. Ata akuzohen se kanë  
5 dëmtuar reputacionin e UÇK-së apo se nuk janë patriotë.

6 Dhe peizazhi, apo mjedisi përkujtimor nuk ndryshon kur  
7 vjen puna te viktimat e luftës në Kosovë. Mjafton të bësh një  
8 shëtitje në shumicën e shesheve në Kosovë dhe të shohësh  
9 statujat e ngritura për anëtarët e UÇK-së. Por edhe të vësh re  
10 se ka vetëm pak që kujtojnë viktimat civile, ndërsa nuk ka  
11 asnjë që të kujtojë viktimat e ngjarjeve ku ushtarët e UÇK-së  
12 kanë qenë kryerësit.

13 Pra situata është shumë më tepër me nuanca se sa  
14 narrativa dyjare e luftës që është imponuar deri më tani. Në  
15 narrativën aktuale është lufta e lavdishme, luftë midis dy  
16 forcave luftarake, forcat serbe dhe UÇK-ja ndërsa kjo në fakt  
17 është vetëm një pjesë e historisë. Ky gjykim është një mundësi  
18 unike për të hedhur dritë në historitë e fshehura të këtyre  
19 viktimave që kanë vuajtur në duart e luftëtarëve të UÇK-së.

20 Dhe ky funksion i gjyqit lidhet me të drejtën e viktimave  
21 për të dëgjuar të vërtetën, e drejta që do t'i kthehem më pas.  
22 Në këtë moment dua të kujtoj një akt-gjykim të Gjykatës  
23 Evropiane të të Drejtave të Njeriut që ju e njihni më së miri,  
24 në çështjen El Masri, ku e drejta për të marrë të vërtetën  
25 është jo vetëm e rëndësishme për viktimat aty por edhe për

1 viktimat e tjera dhe për publikun në përgjithësi, që kanë të  
2 drejtën të dinë atë që ka ndodhur në të vërtetë.  
3 Narrativa e pabalancuar sot pra, ka shumë rëndësi, dhe nuk  
4 është vetëm një shqetësim vetëm për viktimat pjesëmarrëse  
5 këtu, por është e rëndësishme për publikun në përgjithësi.  
6 Pranimi i vuajtjeve të tyre, marrja e dëmshpërblimeve apo e  
7 reparacioneve në këto procedura gjyqësore ka rëndësi jo vetëm  
8 për viktimat që paraqiten këtu. Ajo do të ketë rëndësi edhe se  
9 si një sinjal, një nxitje për të tjerët të cilët kanë një  
10 histori të ngjashme, që të dalin dhe të tregojnë historitë e  
11 tyre. Le ta dinë se nuk janë vetëm në këto beteja.

12 Të nderuar Gjykatës dhe të gjithë ju që jeni duke ndjekur  
13 këtë seancë nga jashtë, asgjë nuk mund të arsyetojë vrasjen e  
14 qëllimshme, torturën dhe trajtimin mizor. Nuk është lufta për  
15 pavarësinë e Kosovës që po gjykohet këtu. Dëgjuam Prokurorinë  
16 që ta përmendi këtë çështje dhe më lejoni të theksoj këtë gjë:  
17 legjitimiteti i luftës së UÇK-së, siç ka përmendur mbrojtja,  
18 në raste të tjera, në asnjë rrethanë nuk ka arsyetuar torturën  
19 ndalimin arbitrar, ndalimin mizor apo vrasjen e qëllimshme.  
20 Ata që luftojnë për pavarësi apo çlirim, pavarësisht nëse  
21 ndodhen në Kosovë apo gjetkë, duhet të respektojnë rregullat e  
22 luftës dhe rregullat e njerëzimit.

23 Tani më lejoni të citoj atë që më tha një nga viktimat.

24 Citoj:

25 "Armiku ishte Serbia. Ne ndihmuam dhe mbështetëm luftën

1 kundër tyre. Ne investuam në luftën e UÇK-së. Ne donim të  
2 luftonim. Armiqtë nuk ishin bashkëkombësit e mi, burra e gra,  
3 dhe ne nuk akuzojmë vlerat e UÇK-së”.

4 Kjo është historia që duhet treguar dhe dëgjuar në këtë  
5 gjyq. Krimet e kryera ishin kundër burrave dhe grave të  
6 akuzuar gabimisht se ishin spiunë, të cilët u ndaluan  
7 arbitrarisht dhe u vranë brutalisht, por viktimat nuk mund të  
8 qanin, nuk mund të flisnin me zë të lartë për atë që ndodhi  
9 sepse stigmatizimi vazhdoi ndaj tyre për vite. Siç thash më  
10 përpara, frika i ka bërë që ta mbyllin gojën.

11 Që Kosova të eci përpara, dhe këtë e them jo vetëm  
12 përpara jush, por përpara gjithë audiencës që e dëgjon, ka  
13 rëndësi që Kosova të rritet si vendi i bukur që është dhe për  
14 këtë duhet të përballet me disa të vërteta të parehatshme.  
15 Tortura është e ndaluar, qoftë në kohë paqeje apo në luftë. Po  
16 ashtu, e drejta ndaj jetës që është e drejta bazë njerëzore.  
17 Këto janë dispozita të detyrueshme në të drejtën ndërkombëtare  
18 dhe ato janë detyruese për gjithkënd.

19 UÇK-ja ka qenë e detyruar të respektonte të drejtën e  
20 jetës, të respektonte ndalimin e torturës po aq sa çdo forcë  
21 që lufton. Krimet janë kryer nga të gjitha anët. Sigurisht kjo  
22 në asnjë rrethanë nuk arsyeton asnjë shkelje të këtyre  
23 ndalimeve apo krime lufte. Rregullat e luftës vlejné për të  
24 gjitha palët, duhet të respektohen. Kaq e thjeshtë është.

25 Ajo që viktimat kërkojnë është pranimi i të keqes që ju



1 është bërë atyre. Ky gjyq është i rëndësishëm sepse do të  
2 zbulojë dhe do të paraqesë në këtë sallë gjyqi disa nga këto  
3 të vërteta të parehatshme. Është shpresa e singertë që  
4 njerëzit në Kosovë do të angazhohen në këto procedura, do të  
5 dëgjojnë dhe do të kuptojnë. Ky gjyq nuk ka të bëjë me  
6 legjitimitetin e luftës për pavarësi. Ky gjyq ka të bëjë me  
7 rregullat bazë të njerëzimit.

8 Një gjyq i vetëm larg, tutje aty në Hagë, nuk do të  
9 ndihmojë brenda natës të korigjojë narrativën e pabalancuar  
10 të luftës, të ngrejë vëllon e heshtjes, të heqë stigmatizimin  
11 që viktimat e UÇK-së kanë përjetuar. Por këto viktima janë kaq  
12 të guximshëm sa të marrin pjesë dhe ne shpresojmë se ky do të  
13 jetë një hap i parë i vogël drejtë ndryshimit.

14 "Pika, pika mbushet pusi". Kjo është ajo që një nga  
15 viktimat më tha mua gjatë konsultimit dhe për mendimin tim e  
16 përmbledh shumë mirë shpresën e tyre se ky mund të jetë një  
17 kontribut i vogël dhe një hap i parë drejtë ndryshimit.

18 Dhe tani po kalojmë te tema e drejtësisë dhe të vërtetës.

19 Të gjitha viktimat që marrin pjesë në këto procedura kanë  
20 shpresë për drejtësi. Kjo është shumë e qartë. Por çfarë në  
21 fakt do të thotë drejtësi? Nga perspektiva e viktimave, ata  
22 duan të shohin ata që janë përgjegjës që t'u kërkohet  
23 përgjegjësi. Të dënohen për krimet që kanë kryer dhe në këtë  
24 gjyq ne fokusohemi tek i akuzuari dhe i akuzuari është Sali  
25 Mustafa, që zgjodhi të mos jetë i pranishëm.

1 Viktimat shpresojnë që ai do të përballet me pasojat që  
2 parashikon ligji për ato vepra për të cilat ai akuzohet, vepra  
3 të cilat ata duhet t'i duronin. Ata shpresojnë se të gjithë  
4 ata që kanë qenë përgjegjës për krimet e kryera të përballen  
5 me drejtësinë në një moment.

6 Që drejtësia të vihet në vend, duhet të kuptojnë situatën  
7 në Kosovë dhe kur them "ne", kjo u drejtohet shumicës së  
8 personave të pranishëm në këtë sallë gjyqi, që nuk janë nga  
9 Kosova, që nuk kanë jetuar apo punuar aty. Kjo formëson  
10 perspektivat dhe mirëkuptimin tonë. Ne duhet të jemi të  
11 vetëdijsëm për këtë hendek kulturor që ekziston dhe që do të  
12 ndikojë në punën tonë.

13 Dhe tani do të prek një çështje që shkurtimisht është  
14 diskutuar gjatë konferencës gjyqësorë. A duhet Trupi Gjykses  
15 të vizitojë vendin e krimit? Nuk ka më gjë të shikosh. Siç ka  
16 thënë Prokuroria po ashtu, mbrojtja nuk shikon ndonjë vlerë në  
17 një vizitë të tillë dhe nga perspektiva kriminalistike kjo  
18 mund të jetë e vërtetë. Provat janë zhdukur prej kohësh.  
19 Zllashi si vend ka ndryshuar dhe kjo m'u konfirmua në bisedat  
20 që pata me viktimat pjesëmarrëse.

21 Megjithatë, siç tha njëri prej tyre, po citoj: "Gjykatësi  
22 duhet të shkojë aty të shohë me sytë e tyre". Por përse  
23 mendoni se mund të ishte e rëndësishme një vizitë e tillë? Dhe  
24 çfarë ka kjo të bëjë me atë hendekun kulturor që përmenda? Unë  
25 shkova vetë në Zllash. Menjëherë sapo mbërrita në fshat, dolën

1 disa burra dhe filluan të pyesin se përse isha aty. Shoferi, i  
2 cili më shpuri aty, u shqetësua shumë dhe kishte shumë ankth.  
3 Ai që në plan të parë dukej si një vend i qetë, paqësor, jo  
4 shumë larg nga Prishtina, në fakt kishte një atmosferë tepër  
5 shtypëse. Një përkujtimore e UÇK-së dhe simbolet e UÇK-së  
6 sundonin në fshat dhe sundojnë edhe sot. Unë mësova shumë  
7 gjatë vizitës sime të shkurtër.  
8 Largësia e atij vendi tregon se çfarë vendi ideal ishte ai, si  
9 një vend për tortura. Cili do t'i dëgjonte britmat e atyre që  
10 torturoheshin? Apo t'u vinte atyre në ndihmë. Gjithashtu më  
11 bëri të kuptoj praninë dominante të UÇK-së. Një vështrim në  
12 Zllash tani do të na lejojë të kuptojmë më mirë se çfarë ato  
13 viktima, të cilët do të japin dëshmi në Gjykatë, kanë  
14 përjetuar. Se si duhet të ketë qenë jeta për ta para 22  
15 vjetësh.

16 Vizita në vendin e krimit mund të jetë një sfidë dhe  
17 mbase mund të mos duket me rëndësi, por ne e parashtrojmë se  
18 një vizitë e tillë do të ishte në interes të drejtësisë.  
19 Rregulla 74 e Rregullave të Procedurës dhe të Provave i japin  
20 të drejtën Trupit Gjykues që ta bëjë një gjë të tillë dhe për  
21 mendimin tonë, duhet ta përdorë këtë të drejtë.

22 Është në interes të drejtësisë që të përdoren mundësit e  
23 tilla për të parë, për t'u përpjekur, për të mbushur hendekun  
24 kulturor që ekziston në mënyrë të paevitueshme.

25 Shpresa për drejtësi është e lidhur ngushtë me shpresën

1 për të kuptuar më në fund se çfarë ka ndodhur, për të gjetur  
2 të vërtetën. E vërteta është një forcë fuqizuese dhe shëruese.  
3 E pranojmë për të shkuarën, për të tashmen dhe për të ardhmen.  
4 Me këto fjalë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio  
5 Guterres, pranonte të drejtat e viktimat për të ditur të  
6 vërtetën, për të gjetur drejtësi dhe për të marrë kompensim në  
7 të drejtën ndërkombëtare. E drejta për të vërtetën kërkon të  
8 dish të vërtetën e plotë lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur,  
9 rrethanat e tyre të veçanta, dhe pjesëmarrësit në to. Ndër të  
10 tjerat dhe për të ditur rrethanat në të cilat janë kryer  
11 shkeljet, si dhe arsyet e tyre.

12 Një prej viktimave të tërthorta që merr pjesë në këtë  
13 proces dhe ka përmbledhur saktë shpresën për të vërtetën kur  
14 tha "duam të dimë kush e ka kryer dhe përse". Dy pyetje të  
15 thjeshta. Kush dhe përse. Duke qenë se ne përfaqësojmë një  
16 grup viktimash, përvojat dhe shpresat e tyre sigurisht nuk  
17 janë të njëjta.

18 Përse? Kjo është një pyetje që është e njëjtë për të  
19 gjitha viktimat. Asnjë prej tyre nuk ka gjetur asnjë shpjegim  
20 se përse u janë nënshtruar rrahjeve, dhunës, lëndimeve. Dhe në  
21 bazë të kësaj është ndërtuar edhe mënyra me të cikën do të  
22 bëhet përfaqësimi i viktimave prej nesh këtu.

23 Do ta ushtrojmë të drejtën tonë për të bërë pyetjen dhe  
24 për të zbuluar se çfarë ndodhi, duke qenë se kjo ka rëndësi  
25 jetike për viktimat që ne përfaqësojmë. Në këtë kuadër , jemi

1 në dijëni të vendimit të Trupit Gjykues për të drejtat  
2 procedurale të viktimave dhe për zhvillimin e procesit  
3 gjyqësor. E mirëpresim mundësinë që na jepet për të bërë  
4 pyetje, sipas rastit, për të zbuluar të vërtetën.

5 I akuzuari nuk është i pranishëm më, por shpresoj shumë  
6 që mbrojtja do t'ja përcjellë zotit Mustafa atë që dua t'i  
7 them, se është në dorën e tij të ndihmojë në marrjen e  
8 përgjigjeve. E respektojmë plotësisht të drejtën e tij për të  
9 qëndruar i heshtur dhe e kuptojmë vështirësinë në të cilën ai  
10 ndodhet. Por, si Mbrojtëse e Viktimave, dua të theksoj se ai  
11 mund të kontribuojë shumë në gjetjen e përgjigjeve. Duart e  
12 kujt e kryen vrasjen e një biri të dashur?

13 I bëjmë thirrje që t'i bëjë ballë përgjegjësisë së tij  
14 dhe të japë përgjigje të tilla. E kuptojmë se kjo thirrje do  
15 të mbetet pa përgjigje tani, duke qenë se vetë ndenjësja që  
16 është bosh flet shumë qartë. Por nuk dua të mos e shfrytëzuar  
17 këtë rast për të nënvizuar se kjo do të tregonte guxim dhe  
18 nder në dhënien e përgjigjeve të tilla.

19 Zbulimi i së vërtetës përmban edhe një element të  
20 paraqitjes, të shprehjes deri në fund të vuajtjes. Viktimat  
21 pjesëmarrëse në këtë proces me status të dyfishtë do të kenë  
22 mundësinë që të japin dëshmi në Gjykatë. Do ta informojmë  
23 Trupin Gjykues në kohën e duhur nëse viktimat dëshirojnë ta  
24 shfrytëzojnë mundësinë për t'ia paraqitur pikëpamjet dhe  
25 shqetësimet e tyre drejtpërdrejtë Trupit Gjykues, përveç

1 deklaratës së dëshmitarit.

2 Të nderuar Gjykatës, tani do të flasim për çështjen e  
3 zhdëmtimit, kështu që i jap fjalën koleges sime, zonjës  
4 Liesbeth Zegveld.

5 ZNJ. ZEGVELD: [Përkthim] Faleminderit.

6 Të nderuar Gjykatës, Prokurori i Specializuar, avokatë  
7 mbrojtës, zoti Mustafa - edhe pse nuk jeni i pranishëm.  
8 Konferenca diplomatike e Konventave të Gjenevës të vitit 1949  
9 theksonte se nuk mjafton t'u jepen të drejta personave të  
10 mbrojtur dhe t'u ngarkohet përgjegjësia shteteve. Personave të  
11 mbrojtur duhet t'u jepet edhe mbështetja e nevojshme për t'i  
12 gëzuar të drejtat e tyre, përndryshe ata do të ishin të  
13 pambrojtur nga ana juridike kundrejt pushtetit në duart e të  
14 cilit ndodhen.

15 Hartuesit e Konventave të Gjenevës kishin të drejtë.  
16 Situata e viktimave, të shkeljeve të së drejtës humanitare  
17 duhet në fund të fundit të vlerësohet në bazë të së drejtës  
18 për të kërkuar zhdëmtim. Kjo e drejtë përfshin mundësinë  
19 procedurale për t'ia paraqitur një kërkesë të tillë  
20 drejtpërdrejtë një organi. Nevoja për të krijuar pikërisht  
21 këto Dhoma të Specializuar të Kosovës jashtë Kosovës dhe të  
22 pajisur me punonjës jo kosovarë është justifikuar me faktin se  
23 do të ndihmonte Gjykatat e tjera të brendshme të Kosovës. Puna  
24 e tyre ka hasur në pengesa. Kjo Gjykatë siguron mbrojtje për  
25 dëshmitarët në mbrojtjen nga korrupsionin dhe ndërhyrje

1 politike. Krijimi i kësaj Gjykate është përshëndetur si një  
2 mënyrë me të cilën Gjykata e Kosovës mund të vendosë në vend  
3 drejtësinë për viktimat e krimeve të së shkuarës.

4 Por legjislacioni i kësaj Gjykate gjithsesi parashikon  
5 referimin e viktimave në padi civile, në Gjykatat e tjera të  
6 brendshme. Kjo është për t'u çuditur. Është e çuditshme se po  
7 të kemi parasysh të gjitha pengesat që ua kanë cenuar punën  
8 Gjykatave të Kosovës. Kjo është kontradiktore dhe cenon  
9 objektivin e këtyre dhomave si dhe të drejtat themelore të  
10 viktimave.

11 Sot do të flas fillimisht për praktikën e gjykatave  
12 ndërkombëtare që i kanë referuar viktimat në gjykatat e  
13 brendshme. Cili ka qenë rezultati i këtyre referimeve? Cila ka  
14 qenë praktika e brendshme? Siç do ta shohim, kjo praktikë e  
15 brendshme është vërtet për t'u brengosur. Pastaj do të flas  
16 shkurtimisht se çfarë duhet pritur nga paditë civile kur  
17 trajtohen në gjykatat kosovare dhe jo nga këto dhoma.

18 Së fundi, për t'ju rikthyer dhomave të specializuara, do  
19 të theksoja rëndësinë që ka zhdëmtimi si një formë  
20 reparacioni.

21 E drejta për zhdëmtim dhe rrugë ligjore tashmë është  
22 përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare. Por sigurisht, deri  
23 tani mund të themi që asnjë gjykatë ndërkombëtare nuk ua ka  
24 mohuar këtë të drejtë viktimave, por tjetër është çështja nëse  
25 duhet të jetë një gjykatë e brendshme apo e jashtme.

1 U mbetet gjykatave të brendshme të veçanta ndërkombëtare  
2 të së drejtës së brendshme t'u japin gjykatës ndërkombëtare  
3 ose atyre të brendshme, ta kryejnë për të zbatuar këtë të  
4 drejtë.

5 Parimet bazë të OKB-së për të drejtat nëpërmjet ligjor  
6 nuk ofrojnë kush e di sa ndihmë për këtë. Do të citoj këtu  
7 parime ose mbështetem te parimet përkatëse të tyre që"

8 "...nuk ofrojnë rrugë ligjore por thjesht identifikojnë  
9 mekanizmat për zbatimin e detyrimeve ligjore sipas Konventës  
10 Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtën  
11 humanitare ndërkombëtare".

12 Neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
13 parashikon se individët duhet të kenë një mjet efektiv ligjor  
14 para një autoriteti ndërkombëtar.

15 Në vitin 1993 me krijimin e TPNJ-së, Këshilli i Sigurimit  
16 ua njihte të drejtat viktimave por nuk i jepte zgjidhje  
17 ligjore vetë. Në TPNJ ideja ishte që t'u drejtoheshin  
18 Gjykatave të brendshme.

19 Pra duket se nuk ekziston një e drejtë e viktimave për të  
20 ndjekur një rrugë ligjore para një organi ndërkombëtar.  
21 Gjithsesi, në të njëjtën kohë gjykatësit e TPNJ-së herë pas  
22 here kanë theksuar se Gjykatat e brendshme i kanë lënë në  
23 baltë viktimat.

24 Në mars të vitit 2011 kryetari i TPNJ-së foli për  
25 pamundësinë e viktimave për të ndjekur rrugën ligjore në



1 gjykatat e brendshme. Fillimisht ai thoshte dhe këtu po citoj  
2 atë:

3 "Tribunali vetëm me lëshimin e akt gjykimeve, nuk mund të  
4 sjellë paqe dhe pajtim në rajon. Mjetet e tjera ligjore duhet  
5 të plotësojnë gjyqet penale nëse duam të arrihet paqja  
6 afatgjatë dhe një mjet i tillë ligjor duhet të jetë zhdëmtimi  
7 adekuat për viktimat për vuajtjet që kanë pësuar".

8 Pastaj ai bënte për krijimin e një fondi besimi nën  
9 kompetencën e TPNJ-së, për viktimat që ishin në kompetencat e  
10 TPNJ-së. Ai këtë e tha nga që Gjykata e brendshme të ish-  
11 Jugosllavisë nuk kishin një mundësi për viktimat.

12 Kjo çështje është trajtuar edhe nga Organizata  
13 Ndërkombëtare për Migrim. Me kërkesë të zyrës së kryetarit të  
14 TPNJ-së, ONM-ja shkruante një raport në vitin 1993, jo më  
15 falni në vitin 2013. Në këtë raport ONM-ja konfirmonte se  
16 shumë, në mos shumica e viktimave, kishin mbetur pa një mjet  
17 ligjor efektiv dhe unë këtu citoj plotësisht një pjesë të  
18 raportit duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj:

19 "Por në praktikë, ONM-ja është informuar se viktimat në  
20 të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë përballen me një larmi  
21 pengesash të pakapërcyeshme për të gjetur rrugë ligjore përmes  
22 gjykatave. Këtu përfshihet mungesa e mjeteve financiare, për  
23 tarifatat e Gjykatave dhe të avokatëve, barra psikologjike dhe  
24 fizike që vendosin mbi viktimat gjyqet gjithnjë të gjata,  
25 pamundësia për të gjetur prova shkresore dhe mungesa e

1 vazhdueshme e dijenisë së viktimave për shkallën e të drejtave  
2 të tyre në këtë aspekt".

3 Së fundi, dhe unë këtu vijoj të citoj raportin:

4 "ONM-ja është e informuar se një vendim për zhdëmtim nuk  
5 garanton një zgjidhje ligjore efektive. Duke qenë se  
6 përmbarimi shpesh ka qenë po aq i vështirë sa edhe vetë  
7 procesi që ka çuar në marrjen e vendimit. Për pasojë, rruga  
8 gjyqësorë nuk ka mundur të sigurojë në mënyrë efektive  
9 zhdëmtim për pjesën dërrmuese të viktimave të krimeve  
10 ndërkombëtare në-ish Jugosllavi", thoshte ONM-ja, duke e  
11 mbyllur se "e njëjta mund të thuhet për shumë rrethana pas  
12 konfliktit në vende të tjera".

13 Vendimi i parë për dëmshpërblim në ish-Jugosllavi është  
14 marr në qershor të vitit 2015. Qershor i vitit 2015. U deshën  
15 20 vjet për këtë. Por edhe kjo ama iu bë e mundur me  
16 mbështetjen e madhe të organizatave joqeveritare. Mes gjithsej  
17 tre çështjeve gjyqësorë në ish Jugosllavi, ku është vendosur  
18 dëmshpërblim, deri tani vetëm një vendim është i formës së  
19 prerë. Avokati në këtë çështje tha se personi i shpallur  
20 fajtor nuk kishte asnjë pasuri ora do të ishte e vështirë që  
21 të përmbarohej dëmshpërblimi.

22 Në përgjithësi, nuk ka asnjë garanci që do të paguhet  
23 qoftë në proces penal, apo në proces civil. Asgjë nuk është  
24 bërë për këtë gjë, as nga TPNJ-ja, as nga shteti i Bosnjës dhe  
25 i Hercegovinës.

1 Njësoj si TPNJ-ja edhe Tribunali i Libanit, i referon  
2 viktimat në Gjykatat e brendshme. Pas mbylljes së gjykimit,  
3 viktimat mund të çelin proces për dëmshpërblim pranë gjykatave  
4 civile libaneze, duke u bazuar në akt gjykimin e Tribunalit të  
5 Libanit. Por Dhoma Gjyqësore e asaj Gjykate ka konfirmuar se  
6 Libani nuk ka skema të përgjithshme kombëtare për zhdëmtimin e  
7 viktimave. Ajo thoshte se, këtu po citoj Dhomën Gjyqësore të  
8 Tribunalit të Libanit:

9 "Sipas të drejtës së Libanit, nuk ka asnjë skemë të  
10 përgjithshme zhdëmtimi për viktimat e krimeve. Viktima e një  
11 krimi mund të kërkojë shpërblim të dëmit të pësuar përmes  
12 bërjes së një padie civile ose pranë të njëjtës gjykate penale  
13 ku janë proceduar kryesit, bashkëpunëtorët e pretenduar, ose  
14 veçmas pranë autoritetit civil kompetent".

15 Unë kam bërë kërkime në jurisprudencën e gjykatave të  
16 brendshme libaneze, dhe nuk kam gjetur asnjë aktgjykim ku të  
17 jetë miratuar dëmshpërblim për viktimat.

18 Në proceset para Tribunalit të Libanit, disa viktima  
19 pjesëmarrëse thanë se kishin marrë një formë zhdëmtimi nga  
20 familja Hariri. Të tjerët morën ca para nga një skemë ex  
21 grazia të drejtuar nga kryeministria e Libanit. Disa kishin  
22 mbulim me policë sigurimi nga e cila mund të kërkonin  
23 kompensim. Disave ua kishin paguar të tjerë shpenzimet  
24 mjekësore. Por shumica e viktimave mbetën pa asnjë zhdëmtim.  
25 Edhe nëse morën një farë zhdëmtimi, ishte e tërësisht jo

1 adekuat.

2 Vendimi i dënimit të Ayyashi-it i datës 2020 fliste për  
3 pamundësinë e viktimave për të kërkuar zhdëmtim në gjykatat e  
4 brendshme. Përfaqësuesit ligjorë kërkonin krijimin e një fondi  
5 besimi për viktimat e krimeve të zotit Ayyash-i. Duke pasur  
6 parasysh mungesën e një skeme të përgjithshme zhdëmtimi për  
7 viktimat në Liban, ata i kërkuan Dhomës Gjyqese të  
8 rekomandonte krijimin e një skeme të tillë. Ata parashtronin  
9 edhe se Dhoma Gjyqese duhet t'i jepte urdhër zotit Ayyashi të  
10 paguante një gjobë ose dëmshpërblim për viktimat pjesëmarrëse.

11 Vetë Dhoma Gjyqese vërente, dhe këtu po citoj:

12 "Provat në gjyq kanë treguar një pabarazi të vërtetë nga  
13 mënyra se janë trajtuar dhe kompensuar viktimat e krimeve të  
14 zotit Ayyashi dhe se si shumica e viktimave nuk janë  
15 kompensuar".

16 Këtu mbyllet citimi. Dhoma Gjyqese e konstatonte se kjo  
17 binte ndesh me parimet bazë të OKB-së për mjet ligjor. Ajo e  
18 bënte të qartë, pra Dhoma Gjyqese e Tribunalit të Libanit, se  
19 është vendosmërisht e mendimit se e ka për detyrë morale dhe  
20 ligjore përpara viktimave të krimeve që konstatohet se bie nën  
21 kompetencën e Tribunalit të Posaçëm, të bëjë gjithçka të  
22 mundshme për t'i ndihmuar të gjejnë zgjidhje".

23 Dhe këtu e mbyll citimin, por Dhoma e Gjyqese vijonte të  
24 pohonte se nuk kishte tagrin t'i jepte urdhrin zyrtarisht  
25 zotit Ayyashi apo qeverisë së Republikës së Libanit. Prandaj

1 ajo rekomandonte dhe këtu citoj:

2 "Qeveria e Republikës së Libanit të krijonte një skemë  
3 kombëtare për zhdëmtimin e viktimave në përputhje me parimet e  
4 OKB-së, dhe krijimin e një fondi të posaçëm për viktimat e  
5 krimeve që konstatohen se bëjnë pjesë në fushën e kompetencës  
6 së Tribunalit të Posaçëm".

7 Duke e parë këtë praktikë, mund të arrihet vetëm në një  
8 përfundim, që referimi i viktimave në gjykatat e brendshme  
9 për të kërkuar dëmshpërblim, nuk mund të jetë një rrugë  
10 zgjidhje. Legjislacioni i brendshëm, kuadri i institucional,  
11 praktika politike dhe burimet, diktojnë nëse viktimat kanë ose  
12 jo mundësi të kërkojnë të drejtat e tyre. Për pasojë, këto  
13 rrugëzgjidhje mund t'i kenë vetëm disa viktimë por jo të  
14 tjera.

15 Gjykatat penale ndërkombëtare ju ofrojnë viktimave një  
16 mundësi shumë më të mirë për të kërkuar dëmshpërblim. Shembuj  
17 janë Gjykata e Posaçme e Kamboxhias dhe Dhomat e  
18 Jashtëzakonshme për Senegalin, ku është proceduar Habreja.  
19 Megjithëse se suksesi i tyre ka qenë jo gjithnjë i njëjtë dhe  
20 tagri i tyre është i ndryshëm, këto gjykata kanë bërë  
21 përpjekje serioze për t'u dhënë viktimave zhdëmtim adekuat dhe  
22 shembulli më i mirë është Gjykata penale ndërkombëtare.

23 Shembulli më i mirë i një rruge premtuese ndërkombëtare  
24 është Gjykata penale ndërkombëtare. Është e vërtetë se qasja  
25 rast pas rasti e GJPN-së ka rezultuar në një jurisprudencë

1 mospërputhëse por çështja më e fundit gjyqësore, Ntaganda,  
2 shërben si një pikë referimi për zhdëmtimin e viktimave. Në  
3 atë çështje Gjykata vendosi në qendër viktimën duke i kushtuar  
4 rëndësi qëllimit të zhdëmtimit të viktimës për dëmin e pësuar.

5 Unë nuk do të hyj në hollësi të praktike të gjykatave të  
6 tjera penale ndërkombëtare që kanë urdhëruar zhdëmtim. Ajo që  
7 dua të theksoj është se duke marrë parasysh që gjykatat  
8 vendore në përgjithësi nuk ofrojnë mjet ligjor për zhdëmtim,  
9 tribunalet ndërkombëtare duhet të përdori të gjitha  
10 kompetencat që kanë për zbatimin e të drejtës së viktimave për  
11 zhdëmtim. Lënia e viktimave në mëshirën e sistemeve juridike  
12 vendore i bën ata të varur nga faktori nëse legjislativet e  
13 brendshme e parashikojnë një mundësi reale për kërkesë për  
14 këtë shpërblim. Shpesh ato nuk parashikojnë një mundësi të  
15 tillë.

16 Këto Dhoma të Specializuara duhet t'i hapin dyert e tyre  
17 drejtë zbatimit të së drejtës së viktimave për zhdëmtim. E  
18 dimë se që të dyja këto mënyra janë ende të mundshme në bazë  
19 të ligjit dhe në bazë të rregullores. Kjo Gjykatë mund të  
20 nxjerrë vetë urdhër për zhdëmtim ose mund t'i udhëzojë  
21 viktimat që të ngrenë padi civile në gjykatat e tjera të  
22 Kosovës. Kjo Gjykatë duhet ta bëjë mundësinë e parë.

23 Përvoja e dhimbshme me Gjykatat vendore duhet të na bëjë  
24 jashtëzakonisht skeptikë kur është fjala për referimin e  
25 viktimave në gjykatat e tjera të Kosovës.

1 Trupi Gjykses në këtë çështje ka kërkuar një mendim  
2 ekspertit në lidhje me këtë çështje dhe ne po e presim këtë  
3 raport që do të dali në fillim të nëntorit. Më lejoni të  
4 trajtoj shkurtimisht disa nga rreziqet që tashmë u kanosen  
5 viktimave, nëse do të udhëzoheshin nga Trupi Gjykses për në  
6 gjykatat civile të Kosovës.

7 Ekziston ligji për kompensimin e viktimave të krimit në  
8 Kosovë. U miratua më në fund në vitin 2015, dy vjet më vonë  
9 filloi edhe programi për kompensimin e viktimave të krimit.  
10 Sipas këtyre programeve, kompensimi nga shteti mund të  
11 kërkohet kur viktima nuk është në gjendje të marrë  
12 dëmshpërblim nga personi i shpallur fajtor ose nga burime të  
13 tjera.

14 Por pikërisht këtu është problemi. Ministria e Drejtësisë  
15 nuk pranoi të konfirmojë nëse programi mbulon apo jo viktimat  
16 e rasteve të krimeve të luftës. Kompensimi dhe zhdëmtimi i  
17 viktimave aktualisht është një lëm i panjohur në gjykimet e  
18 krimeve të luftës në Kosovë madje edhe në rastet kur  
19 aktgjykimet përfshijnë dënime me burgim sistemi ligjor i  
20 Kosovës është treguar dështues në rastin e viktimave që nga  
21 përfundimi i luftës.

22 Një problem tjetër që paraqitet është mbrojtja e  
23 identitetit të viktimave. Ajo që kemi parë në Kosovë është se  
24 gjatë procedimeve penale, identiteti i viktimave është mbajtur  
25 i fshehtë me qëllim mbrojtjen e viktimës por në procedurat

1 civile nuk ka një mekanizëm të tillë ligjor. Për rrjedhojë,  
2 viktimat nuk mundën dhe nuk do të kërkojnë kompensim në  
3 procedurë civile për shkak të rrezikziut të ekspozimit.

4 Një pengesë tjetër është tendenca për stereotipizimin  
5 negativ të viktimave që kërkojnë kompensim. Shembuj të kësaj  
6 kemi parë në shtetet e ish-Jugosllavisë. Një qëndrim i tillë  
7 tregon mungesën e njohurisë së mjaftueshme dhe ndërgjegjësimit  
8 të gjykatësve për të drejtat themelore të viktimave të dëmeve  
9 të lidhur me luftën. Nga shembulli i ish-Jugosllavisë  
10 gjithashtu mësuam se megjithëse disa viktima arritën qasje në  
11 masa ndreqëse ligjore, shumë të tjerë nuk e arritën dhe nuk do  
12 ta arrijnë këtë.

13 Ne duhet të mësojmë nga këto përvoja. Ky Trup Gjykses,  
14 kjo Gjykatë, mund dhe duhet të trajtojë kërkesat e viktimave  
15 plotësisht vetë. Gjykimet dhe në këtë Gjykatë janë të  
16 domosdoshme. Ju jeni i dhimbshmi mjeti i fundit.

17 Do të përfundojmë me disa vëzhgime mbi zhdëmtimin që  
18 kërkojnë klientët tanë në këtë çështje.

19 Para dhe mbi të gjitha, ata kërkojnë procedim penal dhe  
20 shpalljen fajtorë të autorëve të krimeve të kryera kundër  
21 tyre. Procedimi penal në vetvete është pjesë e zhdëmtimit.  
22 Suksesi i kësaj çështjeje gjyqësore në kuptimin e përcaktimit  
23 të së vërtetës, është thelbësor, i rëndësisë thelbësore për  
24 klientët tanë. Por viktimat kanë interesa të ndryshme,  
25 interesat vetjake të tyre.



1 Një prej tyre është që të kompensohen. Është një parim  
2 themelor, ligjor që dëmi i shkaktuar nga një person ndaj një  
3 personi tjetër kërkon masa ndreqëse dhe kompensim. Ky parim  
4 ekziston në çdo sistem juridik të çdo vendi. Ekziston edhe në  
5 të drejtën ndërkombëtar. E drejta për kompensim njihet  
6 gjithashtu edhe në parimet themelore të OKB-së dhe këto parime  
7 i njeh edhe GJPN-ja.

8 Në një çështje të kohëve të fundit që trajton zhdëmtimin  
9 e viktimave përkatësisht në GJPN, Trupi Gjykues vlerësoi se,  
10 në përcaktimin e shumës së përgjegjësisë monetare të personit  
11 të shpallur fajtor, ajo që duhet marrë para së gjithash  
12 parasysh është shkalla apo përmasa e dëmit dhe kostot ose  
13 çmimi i ndreqjes së tij.

14 Ne kemi parasysh vërejtjet e Trupit Gjykues në këtë  
15 çështje, për rëndësinë e së vërtetës dhe se përcaktimi i së  
16 vërtetës mund të jetë edhe më i rëndësishëm se vetë  
17 kompensimi. Ne jemi dakord me rëndësinë parësore të gjetjes  
18 apo përcaktimit të së vërtetës. Por ne gjithashtu i kërkojmë  
19 këtij Trupi Gjykues që t'i kushtojë vëmendjen e duhur të  
20 drejtës së zhdëmtimit.

21 Natyrisht kjo fillon me përcaktimin e shkallës dhe  
22 përmasave të dëmit që kanë pësuar viktimat. Në bazë të nenit  
23 22(7) të ligjit dhe ne kërkojmë shprehimisht që Trupi Gjykues  
24 ta bëjë këtë.

25 Me të drejtën e kompensimit vjen edhe e drejta e zbatimit

1 të kompensimit të urdhëruar. Ligji i lejon Dhomat e  
2 Specializuara të urdhërojnë shitjen dhe ndarjen e pronës,  
3 fitimeve dhe pasurisë së sekuestruar midis viktimave. [REDAKTUAR]  
4 [REDAKTUAR]  
5 [REDAKTUAR]  
6 [REDAKTUAR] Shumë shpesh kemi qenë  
7 dëshmitarë të moszbatimit të zhdëmtimit. Shembuj të tillë janë  
8 Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias dhe  
9 Tribunali i Libanit.

10 Më vonë në këtë procedurë do të trajtojmë nevojën e  
11 mundshme të krijimit të një fondi të mirëbesimit, në se del se  
12 i akuzuari, në qoftë se shpallet fajtor, nuk ka mjete për  
13 kompensimin e duhur të viktimave. Tani për tani dua të  
14 theksojmë se i vlerësojmë pyetjet e Trupit Gjykues në lidhje  
15 me këtë aspekt për ekspertët.

16 Para se t'ia kaloj fjalën koleges sime, më lejoni të  
17 përfundoj në lidhje me zhdëmtimin. Zhdëmtimi i viktimave të  
18 luftës është kërkesë e domosdoshme, kusht i domosdoshëm i  
19 drejtësisë. Rëndësia e të drejtave të viktimave vihet në  
20 pyetje nëse ata nuk kanë kapacitetin, mjetet ligjore për  
21 zbatimin e tyre. Sikurse e ka theksuar Lord Denning:

22 "Një e drejtë pa masa ndreqëse ose mbrojtje ligjore, nuk  
23 është fare e drejtë".

24 Trupi Gjykues duhet të marrë vendimin nëse do të lëshojë  
25 vetë urdhër për zhdëmtim ose nëse do t'i udhëzojë viktimat që

1 të ngrenë padi civile në gjykata të tjera. Në marrjen e atij  
2 vendimi, Trupi Gjykues duhet të udhëhiqet nga pesha e  
3 normative që bashkësia ndërkombëtare i kushton të drejtave të  
4 njeriut dhe të drejtës humanitare, si dhe parimeve mbi të  
5 drejtën për mjet juridik.

6 Ndryshimet që ka pësuar rendi ndërkombëtar reflektohen në  
7 mjetet ligjore të gjykatave penale ndërkombëtare.

8 Interesi i drejtësisë kushtëzon që Dhomat e Specializuara  
9 t'i rezistojnë tundimit për t'ju referuar gjykatave civile. Në  
10 Kosovë kjo do të ishte e gabuar pasi e drejta për mjete  
11 ndreqëse kërkon një zgjidhje tjetër. Viktimat do ta kenë të  
12 vështirë që të arrijnë njohjen e të drejtave të tyre dhe të  
13 dëmit të pësuar në gjykatat e Kosovës. Kjo do të thotë se të  
14 drejtat e tyre në atë rast do të ishin vështirë të arsyetuara.

15 Në interes të ligjit, në interes të interesave të  
16 drejtësisë dhe interesave të klientëve tanë, ne i kërkojmë  
17 Trupit Gjykues që t'i gjykojë vetë këto kërkesa.

18 Ju faleminderit dhe me lejen tuaj, dua t'ia kaloj fjalën  
19 koleges sime.

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Zhdëmtimi duhet të miratohet për të  
21 gjitha viktimat pjesëmarrëse në këtë proces.

22 Asnjë shumë parash nuk mund të kthejë një anëtar të  
23 humbur të familjes. Asnjë shumë parash nuk mund të kompensojë  
24 vitet e tëra të kaluara në depresion, të një jete të privuar  
25 nga mundësitë për të punuar si më parë dhe për të jetuar një

1 jetë që mundëson gëzim dhe lumturi. Megjithatë, sikurse është  
2 theksuar tashmë nga kolegja ime, ne zyrtarisht kërkojmë që ky  
3 Trup Gjykues të përfshijë një vendim mbi shkallën dhe përmasat  
4 e dëmit, humbjes dhe lëndimeve ndaj viktimave ose në lidhje me  
5 të, në përputhje me nenin 22(7) të ligjit.

6 Kjo kërkesë gjithashtu më vonë do të dorëzohet edhe si  
7 parashtrim zyrtar për protokollim.

8 Viktimat gëzojnë të drejtën e zhdëmtimit dhe kolegja ime  
9 e shpjegoi këtë në hollësi. Viktimat kanë të drejtën për  
10 dëmshpërblim dhe që do të dëshmojmë si dëshmitarë, do t'i  
11 ofrojnë Trupit Gjykues mundësinë që të kuptojnë dëmin, humbjen  
12 dhe lëndimin e pësuar. Mbrojtësi i viktimave do të kontribuojë  
13 në përcaktimin e shkallës së ndikimit të krimeve përmes  
14 pyetjeve që do t'u bëjnë viktimave që do të dëshmojnë si  
15 dëshmitarë. Gjithashtu, mund të dorëzojmë dëshmi eksperte për  
16 këtë çështje dhe do ta njoftojmë Trupin Gjykues në kohën e  
17 duhu, në mënyrë që të bëhet organizimi i duhur.

18 Asnjë nga këto gjëra nuk është befasuese sepse ne e kemi  
19 bërë qartë në parashtrimet tona të mëparshme se ky Trup  
20 Gjykues është organi gjyqësor më i përshtatshëm për urdhërimin  
21 e zhdëmtimit.

22 Neni 22(7) parashikon mundësinë e kufizimit të vendimit  
23 në identifikimin e viktimave të krimeve brenda gjykimit të  
24 Trupit Gjykues. Kjo megjithatë bëhet vetëm kur vendimi i  
25 kërkuar për përcaktimin e dëmit do të zgjasë në mënyrë të

1 papërligjur procedurën penale.

2 Ne jemi në fillim të këtij gjykimi. Me parashtrimin tonë  
3 të sotëm, në fillimin e këtij procesi, i kemi ofruar Trupit  
4 Gjykues të gjitha mundësitë që të sigurojë që kjo kërkesë të  
5 mund të trajtohet gjatë të gjithë gjykimit, pa shkaktuar  
6 vonesa të paarsyeshme.

7 Neni 22(8) parashikon urdhërimin e zhdëmtimit kolektiv  
8 ose individual të viktimave. Kërkojmë që Trupi Gjykues të  
9 urdhërojë zhdëmtim individual të viktimave. Kjo sidomos ka të  
10 bëjë me viktimat e drejtpërdrejta të torturës, jeta e të  
11 cilëve është shkatërruar për gjithmonë. Të gjitha këto viktima  
12 meritojnë kompensim individual për vuajtjet që kanë pësuar.  
13 Çdo zhdëmtim kolektiv i mundshëm duhet të jetë plotësues i  
14 zhdëmtimin individual.

15 Miratimi i zhdëmtimit, megjithatë, nuk do të kishte  
16 ndonjë domethënie sikur të mos pajtohej. Kolegia ime e ka bërë  
17 të qartë se vazhdon të jetë jashtëzakonisht e vështirë për  
18 viktimat të marrin zhdëmtim në rastin kur zhdëmtimi është  
19 dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare dhe ne e kemi të qartë se ky  
20 Trupi Gjykues, ju të nderuar Gjykatës, nuk e ndryshoni dot  
21 këtë realitet.

22 Megjithatë, Gjykata është forumi në të cilin drejtësia  
23 duhet të administrohet. Gjithsesi drejtësia nuk ka të bëjë  
24 vetëm me respektimin e rregullave dhe zhvillimit të  
25 procedurave të drejta. Nuk janë të rëndësishme vetëm

1 marrëveshje në sallën e gjyqit. Marrëveshje brenda forumit të  
2 drejtësisë nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të vënë  
3 drejtësi. Sigurisht drejtësia e procedurave është e rëndësisë  
4 thelbësore, por vetëm zbatimi rregullave ashtu siç janë  
5 hartuar nuk nënkupton automatikisht se drejtësia perceptohet  
6 si e vënë në vend.

7 Për ne është e rëndësishme që drejtësia të realizohet, që  
8 ne të arrijmë një rezultat të prekshëm. Prandaj më lejoni të  
9 shfrytëzoj këtë rast këtu dhe t'i bëj thirrje audiencës më të  
10 gjerë sepse klientët që ne përfaqësojmë nuk kanë një forum ku  
11 mund të paraqesin kërkesat e tyre sepse janë të detyruar të  
12 heshtin. T'i bëjmë thirrje qeverisë së Kosovës në qoftë se  
13 dikush na dëgjon dhe bashkësisë ndërkombëtare, që të sigurojnë  
14 se viktimat duhet të mund të realizojnë të drejtën e tyre për  
15 zhdëmtim.

16 Ne kemi parasysh nismën e kohëve të fundit të qeverisë  
17 për të punuar rreth një strategjie të drejtësisë kalimtare.  
18 Siç e kemi bërë të qartë në deklaratën tonë hyrëse sot,  
19 legjislacioni aktual dhe mundësitë për marrjen e zhdëmtimit  
20 për krimet të luftës përjashtojnë disa grupe të viktimave, i  
21 përjashtojnë ata për të cilët ne flasim. Një fond mirëbesimi  
22 për viktimat që do të garantonte realizmin e kërkesave të  
23 viktimave të krimeve që shqyrtohen para Dhomave të  
24 Specializuara të Kosovës, do të ishte një hap domethënës. E  
25 kuptojmë se kjo kërkon vullnet politik dhe mbështetjen e

1 bashkësisë ndërkombëtare dhe të Kosovës.

2 Që të drejtat e viktimave të jenë kuptimplote, ky do të  
3 ishte një hap më i rëndësishëm.

4 Megjithëse thirrja për një fond mirëbesimi  
5 gjithëpërfshirës për viktimat ka edhe dimensionin e vet  
6 politik, ajo kryesisht bazohet në realizimin e të drejtave të  
7 viktimave pjesëmarrëse në këtë proces. Drejtësia nuk mund të  
8 arrihet vetëm me krijimin e një Gjykate dhe respektimin e  
9 rregullave të hartuara. Drejtësia duhet të matet edhe me  
10 rezultatet e arritura.

11 Filozofi indian Sen pyet me vendosmëri nëse analiza e  
12 drejtësisë duhet të jetë aq e ngushtë në mënyrë që të  
13 sigurohet që institucione themelore dhe rregullat e  
14 përgjithshme të jenë të drejta. A nuk duhet vallë të  
15 shqyrtojmë edhe atë që shfaqet në shoqëri, përfshirë llojin e  
16 jetës që njerëzit në të vërtetë mund të jetojnë?

17 Për mua kjo është masa për të bërë një ndryshim të  
18 vërtetë. Shpresoj se thirrja jonë këtu për krijimin e një  
19 fondi kolektiv të mos kalojë pa u dëgjuar. Viktimat që ne  
20 përfaqësojmë. Këtu nuk kanë agjenci dhe platformë për të  
21 ndritur zërin e tyre në lidhje me këtë kaos. Shpjeguar me  
22 hollësi se si zërat e tyre janë heshtur. Të nderuar Gjykatës,  
23 qeveria e Kosovës dhe të gjithë ju që kontribuoni në këtë  
24 Gjykatë, krijimi i një fondi mirëbesimi për viktimat është  
25 pjesa që mungon nga fotografia, pra pamja e plotë. Në të

1 vërtetë kjo është edhe plotësisht në interes të viktimave me  
2 të cilat kam folur, të cilat kanë theksuar se nuk duan ndonjë  
3 kompensim individual nga duart e të akuzuarit, por një fond  
4 kolektiv do të ishte shumë i mirëpritur.

5 Me këtë thirrje më lejoni të përfundoj dhe të përmbledh  
6 qëndrimet tona ligjore si më poshtë:

7 Ne do të shtrojmë mundësinë për të bërë pyetje sipas  
8 rastit, për të kontribuar në zbulimin e të vërtetës dhe për të  
9 nxjerrë në pah ndikimin e plotë të krimeve mbi viktimat.

10 Parashtrojmë se Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh  
11 kryerjen e një vizite të vendngjarjes së krimit për të kuptuar  
12 më mirë kontekstin dhe vendin në të cilin janë kryer krimet.

13 Do ta njoftojmë Trupin Gjykses në kohën e duhur nëse dhe  
14 sa viktima mund të përdorin mundësinë e tyre për t'ja  
15 paraqitur pikëpamjet e veta këtij Trupi Gjykses krahas dhënies  
16 së dëshmisë.

17 Kërkojmë që Paneli të përfshijë një vendim për dëmin,  
18 humbjen dhe lëndimet në përputhje me nenin 22(7) të ligjit dhe  
19 që Paneli të urdhërojë zhdëmtimin individual të viktimave  
20 pjesëmarrëse, në përputhje me nenin 22(8) të ligjit.

21 Me këtë, më lejoni të përfundoj deklaratën time dhe të  
22 theksoj edhe një herë se çfarë mundësie të rëndësishme mund të  
23 paraqesë ky gjykim për të zbuluar vuajtjet e viktimave që i  
24 kanë detyruar të heshtin për kaq gjatë.

25 Më lejoni të përfundoj këtë deklaratë sot me shpresat dhe



1 dëshirat e viktimave, me të cilët kam folur, kanë shprehur për  
2 të ardhmen:

3 "Shpresa ime është që të kem harmoni dhe një jetë të  
4 qetë familjare. Do të doja të jem e lirë, pa frikë se jam në  
5 rrezik".

6 "Dua të krijojme një shtet që me të vërtetë mbron të  
7 drejtat e të gjithëve në mënyrë të barabartë".

8 "Ëndrra ime më e madhe do të ishte të jetoja në paqe, të  
9 mos kem frikë, të gjithë të respektojnë ligjin dhe të jenë të  
10 barabartë në një vend ku respektohet ligji dhe shteti ligjor".

11 Ju faleminderit për vëmendjen.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit shumë zonja Pues.

14 Këtu kemi përfunduar me deklaratat hapëse të Prokurorit  
15 të Specializuar dhe Mbrojtjes së Viktimave.

16 Përpara se të shkojmë për pushimin e drekës, do të doja  
17 të bëja disa komente shumë të shkurtra sepse jemi disa minuta  
18 pasi kemi përfunduar. Atëherë do të doja të thosha që Trupi  
19 Gjykues do të dëgjojë dëshminë 2 dëshmitarëve të ZPS-së nga  
20 data 20 shtator 2021 deri të martën, 28 shtator, 2021.

21 Në përgatitjen për dëshmitë a para do të doja të  
22 informoja palët dhe Mbrojtjen për Viktimat, që duke marrë  
23 parasysh aspektet në lidhje me sjelljen e procedurave që kanë  
24 të bëjnë me mënyrën e marrjes së pyetjeve të dëshmitarëve, pas  
25 marrjes në pyetje të dëshmitarit, Paneli, Trupi Gjykues, mund

1 t'i bëjë një ose disa pyetje zotit Mustafa sa i takon  
2 deklaratës se dëshmitarëve, në përputhje me rregullën 142(2)  
3 të rregullores.

4 Sigurisht zoti Mustafa do të ketë të drejtën që të  
5 qëndrojë i heshtur, nëse vendos kështu.

6 Tani do të bëjmë një pushim dreke deri në orën 14.30.  
7 Pra, më pas do të vazhdojmë me disa prej çështjet e nxjerrjes  
8 së informacionit që do të doja që të diskutoja me ZPS-në,  
9 ndërkohë që kemi një tjetër çështje që do të duhet ta  
10 shqyrtojmë dhe për të cilën do të duhet që të kalojmë në  
11 seancë me dyer të mbyllura. Kjo është një tjetër gjë që do të  
12 bëjmë pas ardhjes së pushimit të drekës.

13 Kaq kisha për të thënë për momentin. Seanca mbyllet këtu.

14 --- Pauza e drekës fillon orën 13.13

15 --- Seanca rifillon në orën 14.30

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
17 lutem uluni.

18 Atëherë po shoh përreth dhe vërej që prania ka ndryshuar  
19 që prej herës së fundit që isha në seancë. Shoh që Prokurori i  
20 Specializuar nuk është më i pranishëm. Nuk e di në qoftë se  
21 kemi ndonjë ndryshim tjetër nga Prokuroria?

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, jo e nderuar Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
24 me përjashtim të Prokurorit të Specializuar, të gjithë të  
25 tjerët janë të pranishëm.



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi kthyer në seancë  
3 me dyer të hapura, e nderuar Gjykatëse.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit, zonja sekretare.

6 Përpara se sa ta mbyllim seancën e ditës së sotme, Trupi  
7 Gjykues dëshiron të diskutojë, siç e përmenda edhe më parë, dy  
8 çështje të cilat kanë të bëjnë me nxjerrjen e materialit.

9 Ndërkohë, çështja e parë është si më poshtë: Trupi  
10 Gjykues vërejtë që ZPS-ja ka nxjerrë kohët e fundit disa  
11 paketa provash, përkatësisht paketat 50 deri në 72. Për Trupin  
12 Gjykues, kur shikon paketat në *Legal Workflow*, pra në sistemin  
13 e Gjykatës, nuk është e qartë se çfarë përmban secila prej  
14 paketave. Nuk është e qartë në qoftë se ndërkohë është bërë  
15 rinxjerrje e materialeve të paredaktuara të dëshmitarëve, nuk  
16 është e qartë se me cilin dëshmitar lidhen materialet e  
17 ngarkuara, nuk dihet në qoftë se materiali është shfajësues  
18 dhe cili është niveli i konfidencialitetit të dokumenteve dhe  
19 në qoftë se ato janë pjesë e listës materiale të parashtruara  
20 nga ZPS-ja në parashtrimin e protokolluar F201.

21 Në mënyrë që ne të marrim një lloj informacioni, të kemi  
22 një panoramë më të qartë, do të na duhet që të hapim  
23 dokumentet njëri pas tjetrit në sistemin e Gjykatës. Kështu që  
24 do të jetë e vështirë për neve që të orientohemi në të gjitha  
25 këto paketa.

1           Nga ana jonë, do ta vlerësonim shumë në qoftë se ZPS-ja  
2 mund të parashtrojë shënimet e nxjerrjes edhe në qoftë se mund  
3 të jenë për shembull në formën e një tabele, duke për shkruar  
4 informacione që unë sapo përmenda pak më parë, si dhe numrin e  
5 identifikimit ERN për paketat 50 deri në 72, si dhe për  
6 paketat e tjera që do të nxirren në të ardhmen. Kjo do të na  
7 ndihmonte pa masë dhe besoj që do të ndihmonte edhe palët e  
8 tjera, dhe pjesëmarrësit që t'i kalonin informacionet dhe këto  
9 paketa pak më shpejtë se sa po t'i hapnin ato njëra pas  
10 tjetrës.

11           A do të ishte e mundur, zoti Prokuror, të bënit një gjë  
12 të tillë? Dhe në qoftë se thoni po, atëherë ju lutemi na jepni  
13 një afat kohor për këtë. Fjala për ju.

14                               [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

15           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni  
16 të jap disa shpjegime sa i takon kësaj çështjeje.

17           Në fakt nga paketa 50 ne kemi filluar me nxjerrjen e  
18 materialit që është nxjerrë edhe më parë. Megjithatë, kësaj  
19 here ne po i nxjerrim këto materiale në një format të  
20 paredaktuar, në mënyrë që Mbrojtja të ketë mundësi që të  
21 përgatite më mirë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, në  
22 veçanti të dëshmitarëve të parë të Prokurorisë dhe në mënyrë  
23 që ju të gjithë të nderuar Gjykatës të keni të gjithë  
24 informacionet përpara në momentin kur ne të fillojmë të marrim  
25 në intervistë dëshmitarët nga java që vjen e në vijim.

1 Në qoftë se ka paqartësi sa i takon përmbajtjes së  
2 paketave dhe e kuptoj që mund të ketë paqartësi dhe do të doja  
3 t'ju kërkoja ndjesë solemnisht për këtë gjë, ne sigurisht në  
4 qoftë se ka paqartësi, mund të japim informacion sa i takon  
5 paketave dhe çfarë informacioni përmban secila prej këtyre  
6 paketave, dhe t'ja u japim këtë informacion brenda kësaj jave,  
7 jo më vonë se sa kaq.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit, zoti Prokuror. Në këtë rast do të jap një urdhër  
10 me gojë lidhur me këtë çështje lidhur me atë çfarë duhet të  
11 përmbajnë shënimet e nxjerrjes së materialit. Urdhri është si  
12 më poshtë:

13 Unë urdhëroj ZPS-në që të parashtrojë shënimet e  
14 nxjerrjes për paketat provuese me numër 50 deri në numrin 72,  
15 si dhe për paketat e tjera, përfshirë informacionin e  
16 mëposhtëm. Numrin ERN për secilin prej materialeve që  
17 përmbahen në paketa, një përshkrim të përmbajtjes së secilës  
18 prej paketave, përfshirë këtu edhe rinxjerrjen me versionin më  
19 pak të redaktuara të materialit të dhënë më parë, në qoftë se  
20 ato jepen në listën e shtojcës 1 të parashtrimit të  
21 protokolluar 201 dhe duhet po ashtu të përcaktohet rregulli  
22 dhe rregullat ndër të cilat bëhet nxjerrja e materialit dhe  
23 nivelin e konfidencialitetit për secilin prej këtyre  
24 materialeve.

25 Ky është fundi i urdhrit me gojë.

1 Tani më lejoni të kaloj te çështja e dytë. Trupi Gjykses  
2 vëren se disa nga numrat ERN të dokumenteve të treguara për  
3 dëshmitarët gjatë intervistimit të ZPS-së nuk mund të gjenden  
4 në sistemin e brendshëm të Gjykatës që quhet *Legal Workflow*.  
5 Mbase kjo ndodh sepse ato janë ri numërtuar. Kam disa shembuj,  
6 një prej tyre është deklarata e dëshmitarit 05393. Pra ju po  
7 tundni kokën, nuk e di në qoftë se mund të konfirmoni këtë gjë  
8 ose nëse mund të jepni një tjetër shpjegim për një situatë të  
9 tillë.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar, neve kur i kemi  
11 parashtruar provat materiale të dëshmitarëve, neve ju japim  
12 një numër të ri ERN identifikimi të tërë provave materiale dhe  
13 ndërkohë edhe paketat nga 50 deri në 72 kanë si qëllim kryesor  
14 që të qartësojnë dhe të japin numrat e saktë dhe këto janë  
15 numra të cilat ne do të përdorim gjatë marrjes në pyetje të  
16 dëshmitarëve.

17 Ne mendojmë që pas dhënies së shënimit të nxjerrjes së  
18 informacionit dhe shpjegimeve përkatëse, të cilat juve i  
19 përmendët në urdhrin me gojë, do të jetë e qartë për të gjitha  
20 paketat se çfarë informacioni jepet dhe njëherë më lejoni të  
21 them se në qoftë se ka pasur ndonjë paqartësi, ne ju kërkojmë  
22 ndjesë.

23 Pra ne kemi ricaktuar numrat, pra kemi rinumërtuar dhe do  
24 të donim t'ju kërkonim edhe një herë ndjesë dhe do të  
25 mundohemi që çdo gjë ta bëjmë të qartë për të gjitha palët.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
2 është e mundur që të marrim një tabelë konvertimi që përfshin  
3 si numrin e vjetër të provave materiale edhe numrin e ri që ju  
4 u keni dhënë atyre? Sepse në qoftë se kemi një tabelë të tillë  
5 atëherë besoj se është e thjeshtë për neve për të  
6 identifikuar, pra mund të identifikojmë vetë pra se cili është  
7 numri ri që i keni dhënë dokumentit.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, pa problem, e japim një  
9 tabelë të tillë.

10 Por thjesht për të shmangur paqartësitë, për shembull, në  
11 qoftë se ju shikoni një dokument, një fotografi, pra  
12 fotografia në fillim të dokumentit ka një numër dhe pastaj më  
13 tej në dokument ka një numër tjetër kështu që besoj që është  
14 më e thjeshtë në qoftë se përdorim pra të njëjtin numër  
15 identifikimi të dokumenteve dhe sigurisht që do t'ju japim një  
16 tabelë të tillë specifike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
18 do të marrim edhe një tjetër urdhër me gojë. Urdhri është si  
19 më poshtë:

20 E urdhëroj Prokurorinë e Specializuar që të japë, le të  
21 themi, numrin e caktuar, pra numrin e saktë le të themi për  
22 të gjitha provat materiale që do të përdoren dhe ky është  
23 fundi i urdhrit tjetër me gojë.

24 Tani po shoh palët, po shikoj gjithashtu edhe mbrojtjen e  
25 viktimave për të parë në qoftë se ata kanë ndonjë çështje

1 tjetër që duan të shqyrtojmë sot.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, ne nuk  
3 kemi asgjë tjetër për të shtuar për seancën e sotme.

4 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë as ne për të  
5 thënë.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar, pra vura re që ZPS-ja  
7 ka bërë një parashtrim për materialin përmes mocionit të  
8 paraqitjes së drejtpërdrejtë të provave për Trupin Gjykses dhe  
9 thjesht doja të dija se në çfarë faze është një mocion i tillë  
10 i ZPS-së. A ka ndonjë vendim të marrë nga Trupi Gjykses lidhur  
11 me të.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e  
13 kam plotësisht parasysh se cilit parashtrimi po i referoheni.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua që të kem qartësi, duhet ta  
15 kem të qartë sa i takon këtij dokumenti dhe do të doja  
16 gjithashtu që të kisha qartësi edhe sa i takon dokumenteve dhe  
17 pranueshmërisë së këtij mocioni nga Trupi Gjykses.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra  
19 ne do të marrim një vendim pozitiv. Për shembull në qoftë se  
20 do të ketë një kërkesë që do të bëhet mbi bazën e nenit 37,  
21 ndërkohë që për të tjerat nuk do të marrim asnjë vendim.

22 Megjithatë, siç është përcaktuar në vendimin për  
23 pranueshmërinë, juve mund të jepni konstatimet tuaja. Jemi  
24 ende në këtë periudhë, pra brenda afatit kur ju mund të jepni  
25 konstatimet tuaja.

1 Pra do të ketë, në qoftë se është e nevojshme, një vendim  
2 të shprehur sa i takon asaj që parashikohet në ligj dhe  
3 rregullore dhe nuk e dimë në qoftë se e qartësova pyetjen  
4 tuaj, zoti Von Bone apo jo.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Cili është afati kohor për  
6 konstatimet e Mbrojtjes?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 qoftë se nuk e kam gabim, kemi planifikuar datën 24 shtator,  
9 parashtrimin e protokolluar 169, paragrafi 43 deri në 45 dhe  
10 paragrafi 45 dhe 46. Nuk e di në qoftë se doni që ta përsëris.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po ju lutem.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e  
13 kuptoj. Përgjigjet duhet që të parashtrohen deri në 24  
14 shtator, parashtrimi i protokolluar 169, paragrafi 43 deri në  
15 45 dhe paragrafi 35 dhe 36. Quhet mocioni i parashtrimit të  
16 provave të drejtpërdrejta në parashtrim, por ne nuk do ta  
17 quajmë kështu por do ta quajmë një listë me materiale.

18 Nuk e di në qoftë se është e qartë përgjigja ime apo jo.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, shumë e qartë. Faleminderit,  
20 e nderuar Gjykatëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
22 ka mbetur gjë tjetër për t'u ngritur për sot. Kemi ardhur në  
23 fund të procesit gjyqësor sot. Dua të falënderoj palët, dua të  
24 falënderoj Mbrojtjen e Viktimave, skuadrën, Zyrën e  
25 Administrimit dhe në veçanti do të doja që të falënderoja

1 përkthyesit, stenografët dhe teknikët audio-vizualë dhe  
2 gjithashtu edhe personelin e sigurisë dhe sekretaret e  
3 Gjykatës për ndihmën e tyre sot.

4 Seanca mbyllet këtu.

5 --- Seanca mbyllet në orën 14.47

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25